



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0069

OSHP:2025/0070

OSHP:2025/0072

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “TALA ENGINEERING” SH.P.K., OE “ANESI” SH.P.K., si dhe OE “Item EL” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të “KOMUNA LIPJAN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra” me numër të prokurimit 613-24-7288-2-1-1, me 11/04/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohen, si pjeserisht të bazuara ankesat e OE “TALA ENGINEERING” SH.P.K. me nr. 2025/0069, e datës 26/01/2025 si dhe OE “ANESI” SH.P.K., me nr. 2025/0070, e datës 27/01/2025, aprovohet si e bazuar ankesa e OE “Item EL” SH.P.K. me nr.2025/0072 e datës 27/01/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra” me numër të prokurimit 613-24-7288-2-1-1.
2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “KOMUNA LIPJAN”, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra” me numër të prokurimit 613-24-7288-2-1-1 kthehet në Rivlerësim sipas arsyetimit në vendim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Me qenë se ankesa e operatorve ekonomik ankues 2025/0069 dhe aprovohen si pjeserisht, dhe ankesa nr 2025/0072 e bazuara 2025/0070 të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.07.2024, "KOMUNA LIPJAN" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra" me numër të prokurimit 613-24-7288-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës sherbim, vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00 €.

Me 09.01.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë OE ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K

Me 13.01.2025, OE "TALA ENGINEERING" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 14.01.2025 OE "ANESI" SH.P.K., me datën 14.01.2025, "Item EL" SH.P.K., kan parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 16.01.2025,dhe me dt 17.01.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilin ka refuzuar si të pa bazuara ankesat e të tre Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 26.01.2025, OE "TALA ENGINEERING" SH.P.K.,ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2025/0069 me datë 27.01.2025 OE "ANESI" SH.P.K., ankesën me nr.2025/0070 me datën 27.01.2025 "Item EL" SH.P.K., ankesën me nr.2025/0072 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra" me nr te prokurimit 613-24-7288-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se të tri ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0069-0070-0072/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "TALA ENGINEERING" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Me datën 09.01.2025 përmes e-prokurim@rks-gov.net nga AK kemi pranuar „Leter Standarde për tenderuesinë e eliminuar “” ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: „Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra ” me nr. prokurimi: 613-24-7288-2-1-1

TALA ENGINEERING SHPK ushtron të drejtën e saj ligjore që përmes kësaj ankese të drejtuar Panelit të Organit shqyrtues të prokurimit, të argumentuar me prova dhe të bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, ta ankimoj vendimin e shpallur nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Lipjan vendim I cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore konkretisht ligjit të prokurimit publike në Kosovë.

Sipas Ligjit për prokurim Publik të Republikës së Kosovës nr 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/ L-092, Autoriteti Kontraktues duhet të rivlerësojë edhe njëherë vendimin e datës 09.01.2025 sepse ka rekomanduar për kontratë një Operatore ekonomik të papërgjegjshëm, ku me këtë rast është shkelur vendimi I OSHP-se me nr 2024/0962 të datës 16.12.2024. ku të gjithë Operatorët ekonomik duhet të trajtohen të barabartë.

Vendimi i OSHP-se i datës 16.12.2024 i jep të drejtë RAPORTIT TË VLERSIMIT TË DY EKSPERTEVE, ku në këto dy raporte, kërkohej që nësi OE i rekomanduar për kontratë të na kërkohej sqarime shtesë në lidhje me pikat e cekura në raport, të kërkohej sqarime në lidhje me furnizimet e materialeve të kërkuara FATURAT E BLERJES, ose DUDAT DOGANOR për materialet të cilat I kemi në STOQË për kryerjen e punimeve, e AK nuk e ka zbatuar fare këtë vendim të OSHP-se, por ka bërë eliminimin e kompanisë tone me qëllim për hakmarrje, dhe ka rekomanduar një OE tjetër për kontratë i cili është i papërgjegjshëm dhe në kundërshtim me RAPORTIN E VLERSIMIT TË DY EKSPERTEVE në të cilën këto dy raporte janë të vërtetuara me vendim të OSHP-se të datës 16.12.2024 në nr 2024/0962.

Autoriteti kontraktues rekomandon për kontratë një OE me cmime minimale të gjitha nga 10 cent dhe 1 euro, por nuk I kërkon as deshmë sipas nenit 41 Tenderet Jo-Normalisht të Ulet,

41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët". duke u bazuar në vendimin e OSHP-se të datës 16.12.2024 në nr 2024/0962, dhe raporteve të eksperteve AK duhet të kërkon edhe dudit doganor si deshmë që OE ka material të nevojshëm për kryerjen e punimeve me këto cmime.

Si është e mundur që në të eliminon në për cmime të ulëta ndërsa të rekomandoni për kontratë një OE me cmime të njejta.

Në vazhdimësi shikoni cmimet e ulëta të OE të rekomanduar për kontratë.

Pretendimet Ankimore për Operatorin Ekonomik të papërgjegjshëm të rekomanduar për kontratë ELEKTRIKA-MONT SHPK.

Ne baze te vendimit te OSHP-se 2024/0962 dhe dy Raporteve te Eksperteve, duke prolonguar per tenderit me cmime jonormalisht te uleta, AK ka rekomanduar per kontrate nje OE me cmime jashtzakonisht te uleta, e cila tregon bindshem se duke krahasuar me cmime te tregut keto punimeve nuk mund te kryhen.

Shiko cmimet e OE te rekomanduar per kontrate Elektri-Mont Shpk

Kalkulimi i nje pozicioni edhe pse te gjitha pozicionet jane ne kundershtim me vendimin e OSHP-se. Ku te gjitha cmimet jane te uleta por vetem nga disa do te argumentojm llogaritjen me qmimet te tregut.

Poz 12, eshte 2 euro ,ndersa po te kalkulojme kete cmim me gjendjen faktike te tregut sa duhet te kushton eshte:

- Lira kushton 16 euro vetem pregaditja,
- Poqi eficient eshte 12 euro vetem blerja
- Montimi eshte 15 euro per cope

Total 43.00 euro per cope shpenzim , Ndersa ne paramase çmimi eshte 2 euro I cili eshte 21 here me I lire se cmimi I tregut.

Poz 4 I cili eshte 20 euro, po ta shohmi nga kendveshtrimi I pozicioneve nga 10 cent mund te themi se ketu paska qmim por llogaritja me qmimet e tregut eshte ne kundershtim me Nenin 41 te Rregullores 001/2022.

Sepse cmimi i tregut per kete pozicion eshte, vetem blerja e drites eshte minimum 35 euro, dhe montimi 15 euro per nje cope, Total 50 euro, pa llogaritur pjesen e fitimit te kompanise, pjesen e Tvsh, pjesen e stafit Teknik dhe te gjith punetoret sipas kerkeses se dosjes se tenderit.

Ne asnje pozicion nga 100 pozicione te cilat jane ne paramase nuk eshte nje cmim I vetem I baraspeshuar me cmime te tregut.

Shiko cmimet e paramases.

Shiko te gjitha cmimet me 1 euro, Furnizim dhe montim,

Nje relekohore ne treg per te blere kushton 22 euro, montimi 15 euro TOTAL 37 euro cmimi i tregut Shiko cmimet 0.50 cent dhe 1 euro

Poz 42, eshte i vendosur 3 euro mund te themi si cmimi me I larte ne paramase, ndersa cmimi i tregut Lira kushton 16 euro, Drita 50 w, kushton 20 euro, Montimi 15 euro per cope dhe total Furnizim dhe montimi eshte 51 euro per cope. Pa llogaritur pagat e inxhinierave, stafit Teknik, punetoret e kerkuar ne dosje te tenderit dhe pjesen e konsideruar te fitimit.

Autoriteti Kontraktues ne kete rast fare nuk e ka zbatuar neni 41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të

pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët".

Shiko pozicionet e paramases me cmim 0.10 cent.

Me kete rast AK ka vepruar ne kundërshtim me Nenin: 41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zërbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët". E Cila është kërkesa e vendimit të OSHP-se 2024/0962

Neni 41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë:

- a. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elemente

Me keto cmime të paramases vet Elektri i Mont Shpk I rekomanduar për kontratë ka deklaruar si citon:

Ndërsa AK e rekomandon për kontratë një OE i cili ka deklaruar se nuk mund të krynte punimet me keto cmime.

Pretendimi ankimore 2.

Te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2 është kërkuar: Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës sistemi 5 vjeçar apo master dega Automatika dhe Elektronika,

Ndërsa Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë Elektri i Mont Shpk ka paraqitur Avdurrahman Krasniqi Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës i cili është i lindur me datën 19.09.1958 i cili i bie që ky inxhinier ka 66 vjeq, dhe në bazë të ligjit të punës 03/L-212 nuk ka të drejtë punësimi me kontratën e paraqitur në mes Elektri i Mont Shpk dhe Avdurrahman Krasniqi.

Kërkesa e AK ka qenë që parakontrata të jetë me validitet e cila nënkupton që gjatë gjithë kohës së projektit ky person të jetë prezent, ndërsa ky person nuk ka të drejtë punë sipas kontratës të paraqitur (SHIKO KONTRATEN E PARAQITUR PAGESA BRUTO) sepse është mbi moshën

65 vjeqare e cila pasqyron se OE i rekomanduar per kontrate nuk ka prezantuar Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes sistemi 5 vjeqar apo master dega Automatika dhe Elektronika, dhe eshte i papergjegjshem duke mos plotesuar kerkesat e dosjes se tenderit.

Ne kontraten e paraqitur mes ElektriKa Mont Shpk dhe Avdurrahman Krasniqi ne Nenin 4 te kontrates eshte e cekur paga mujore prej 600 euro BRUTO

Ne moshen 66 vjeqare nje inxhinier I punesuar nuk ka te drejt te paguhet bruto dhe kjo kontrate eshte jovalide, qe argumenton se ElektriKa Mont Shpk nuk ploteson kerkesen e dosjes se tenderit per inxhinierin e kerkuar.

Shiko kontraten jovalide

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE “TALA ENGINEERING” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca: Neni 26 - RrUOPP Kriteret e Perzgjedhjes, Neni 41 i Rregullores 001/2022. Neni 52 - Njoftimi I kriterëve për dhënien e kontratës, Paragrafi 1,2,3,4, Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahaskimi I Tenderëve Paragrafi 2, Neni 60 - Kriteret për dhënien e Kontratës Paragrafi 1, Nenparagrafi 1.1, 1.2 Paragrafi 2. DUKE U BAZUAR NE PROVAT, ARGUMENTET DESHMITE SI DHE SQARIMET E MESIPERME KERKOJME NGA OSHP , QE TE MERR NJE : VENDIM te APROVOHET si e bazuar ankesa e grupit te OE; Tala Engineering Shpk & Construction Group Shpk & Muharrem Hoti B.I ANULOHET Njoftimi dhe Vendimi i AK ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit i dates 09.01.2025 dhe lenda të kthehet ne RIVLERSIM,. TE DETYROHET autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit, vleresimit dhe krahaskimi i ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, dhe konform dispozitave ligjore të LPP-së Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “TALA ENGINEERING” SH.P.K., Grup i Operatorëve Ekonomik e Grupi O. E. TALA ENGINEERING SH.P.K & CONSTRUCTION GROUP SHPK & MUHARREM HOTI B.I të dt. 13.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1, në këtë aktivitet AK ka shpallur fitues ELEKTRIKA-MONT SHPK Lipjan., për shpërbllim me kontratë të datës 09.01.2025, dhe ka publikuar ne platformën elektronike e-prokurimi.

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si mëposhtë: Sa i përket pretendimit të tenderuesit ankues se Raporti i eksperimentit shqyrtues rekomandon që këtij tenderuesi t’i kërkohen informata shtesë nuk qëndron për arsye se me Vendimet e OSHP-së nr OSHP 2024/0977, të datës 12.12.2024, kjo dhe rrjedhshëm e ka sqaruar ofertën e tenderit ankues Grupi O. E. TALA ENGINEERING SH.P.K & CONSTRUCTION GROUP SHPK & MUHARREM HOTI B.I, në vazhdim po i cekim disa nga arsyetimet pse ky tenderues është i pa përgjegjshëm.

1.Krahaskuar me ofertat e tjera ka çmim jo normalishtë të ulët sepse nga gjithsejt 92 pozicione vetë 4 pozicione ka çmime që mund të quhen çmime të tregut, ndërsa 88 të tjera kanë çmime nga 0.10€ që nuk përkojnë aspak me çmimet e tregut. Në fund të këtij vendimi do të keni të bashkangjitur pjesën nga vendimi i OSHP-së. Kjo nuk është arsyeja e vetme pse tenderi në fjalë është shpallur tender i eliminuar sepse tenderuesi në fjalë nuk ka arrit të dëshmojë se ka kryes shërbime të ngjashme të ofrojë dëshmi në vlerë prej 150000.00€ siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Tenderuesi ankues ka ofruar dëshmi (referenca) vetëm në vlerë prej 50000.00€ të gjitha referencat e tjera nuk i ka për shërbime mirëmbajtje ndriçimit por ndërtim për këtë jepet sqarim edhe në Vendimin e OSHP-së të lartë cekur që edhe kjo pjesë do të jetë e bashkangjitur në fiind të këtij Vendimi, ky tenderues është i eliminuar për arsye se nuk e ka plotësuar edhe kushtim për të dëshmuar se të gjithë anëtarët e grupit janë të pajisur me ccertifikata ISO, sipas kërkesës së AK në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, e cila situata rregullohet me nenin 26 e RRPP-001/2022 paragrafi 6.

2.Sa i përket pretendimit të dytë se operatori i shpallur fitues nga AK ka çmime jo normalishtë të ulta ky pretendim nuk qëndron për arsye se të gjitha ofertat e pranuar kanë laramani të çmimeve në pozicione të ndryshme dhe krahasuar me ofertën e tenderuesit ankues është më afër çmimeve të tregut. Sa i përket pozicioneve të përmendura nga tenderuesi ankues pozicioni 12 dhe 42 nëse i krahasojmë me disa nga ofertat e pranuar në këtë rast shohim se nuk mund të konkludojmë se janë çmime jo normalishtë të ulta, në vazhdim po i përmendim disa çmime nga tenderuesit për këto pozicione.

Sa i përket pretendimit tjetër se fitues është shpallur nje OE e cila nuk i ka plotësuar kërkesat nga AK tek pika 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe professional: Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes sistemi 5 vjeçar apo master dega Automatika dhe Elektronika nuk qëndron.

Tenderuesi i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar këtë kriter duke ofruar dokumentacionin siq është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit ,ndërsa sa i përket moshës së ing që ka kontestohet nga tenderuesi ankues nuk qëndron për arsye se ligji nuk e ndalon për të punuar pas moshës 65 vjet e sidomos për profesionet deficitare siq janë ing.

Sa i perket pretendimit tjetër ne lidhje me Nenin 7- Barazia ne trajdim/Jo-Diskriminimi dhe transparenca, ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues perkatesishte komisioni i vleresimit konsideron se ka vepruar konforme kerkesave dhe deshmime te kërkuara ne baze te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate per kete aktivitet te prokurimit, si dhe duke i*u permbajtur dispozitave ligjore te LPP-sc. AK me kete rast konsideron se per kete aktivitet te prokurimit ka nxjerr vendim te drejtë, te arsyeshem dhe meritore duke i'u permbajtur nenit 7, paragrafeve 1, 2 dhe 4 te LPP-se, i cili garanton trajtim te barabarte, jodiskriminues, transparente dhe konkurrues ne mes te Operatoreve Ekonomik.

Sa i përket pretendimit tjetër ne lidhje Neni 59 - Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, edhe ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues ne baze te dispozitave ligjore te LPP-se perkatesishte nenit 59 ka kerkuar sqarime shtese me ane te letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit nga te gjithë Operatoret Ekonomik mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve dhe duke ju permbajtur dispozitave ligjore te LPP-se ne baze te neni 59 te këtij ligji.

Sa i perket pretendimit tjetër ne lidhje Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se AK ne baze te paragrafit 1.1 te këtij neni ka rekomanduar për kontrate OE me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ANESI” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së pasi që gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit nuk ka luajtur aspak rol aktiv që shpenzimi i parasë publike të bëhet në mënyrë efikase, ekonomike dhe transparente si dhe nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. E themi këtë sepse AK po tenton ta shpërblej me kontratë një OE i cili nuk posedon çmimin më ulët në krahasim me neve si dhe i njëjti nuk e plotëson kriterin për njërin nga inxhinierët e kërkuar nga AK ngjashëm siç na ja bërë vërejtje edhe neve. Përpos kësaj ky OE posedon borxhe në ATK dhe se nuk ka ofruar fare dëshminë(marrëveshjen) që do të tregonte se marrëveshja për shlyerjen e borxheve është bërë para njoftimit për kontratë. Në bazë të kësaj po shihet se AK e ka favorizuar OE në fjalë dhe e ka shpërblyer me kontratë në kundërshtim me të gjitha rregullat që flasin për vlerësimin e tenderuesve duke u bazuar ekskluzivisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat ligjore që përcaktojnë përgjegjshmërinë e OE. Vlen të thuhet se në të njëjtën kohë neve na ka eliminuar pa asnjë të drejtë ligjore edhe pse i kemi plotësuar kriteret e kërkuara për stafin dhe pajisjet, ngjashëm me OE që e ka shpallur fitues por që kemi pasur edhe çmimin më të ulët në krahasim me tenderuesin që e ka shpallur fitues. Përpos kësaj AK nuk na ka kërkuar sqarime për pajisjet tona që i kishim në listë për derisa tek tenderuesit tjerë e ka bërë këtë sqarim.

Nisur nga krejt kjo, nuk kemi se si të mos mendojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 7 të LPP-së gjatë këtij procesi të vlerësimit përkatësisht të përzgjedhjes së fituesit.

2. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne e themi se AK ka shkelur nenin në fjalë për faktin se OE ELEKTRIKA MONT SH.P.K. nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për Inxhinierin e Diplomuar të Elektroteknikës sipas kërkesës së AK-së, ka borxhe ndaj ATK-së dhe nuk e ka dëshmuar se marrëveshja me ATK-në është e lidhur para datës së njoftimit për kontratë. Tani në vazhdim po pasqyrojmë mangësitë e tilla të këtij OE duke paraqitur pretendimet tona për mos plotësimin e kërkesave të dosjes së tenderit ashtu siç AK i kishte kërkuar dhe ashtu siç e kërkon edhe ligji dhe rregullat tjera të prokurimit publik. Po ashtu këtu do pasqyrojmë duke argumentuar edhe se tenderi jonë është i përgjegjshëm për çka AK është dashur që kontratën në fjalë të na jep neve.

Mangësia 1: AK kishte kërkuar ndër të tjera që OE të posedojnë në stafin e tyre një Inxhinier me një profesion dhe përvojë specifike. Kërkesa e tillë e AK-së duket kështu:

OE në fjalë nuk e ka plotësuar këtë kriter saktë qysh e ka kërkuar AK sepse në vend të inxhinierit me drejtim “AUTOMATIKA dhe ELEKTROTEKNIKA” ka paraqitur inxhinierin me drejtimin AUTOMATIKË ME ELEKTRONIKË”. Me që neve na ka eliminuar vetëm për këtë kriter atëherë ne po e kundërshtojmë pranimin edhe të kësaj diplome me që edhe kjo nuk është saktë sipas kërkesës së AK-së. Nisur nga standardi që AK ka aplikuar tek tenderi jonë e që i njëjti standard sipas ligjit duhet aplikuar edhe tek secili konkurrent, del që OE ELEKTRIKA MONT SH.P.K. nuk e ka plotësuar kërkesën e tillë. Ja si duket diploma e ofruar nga ky OE:

Me që kërkesa e AK-së për drejtimin ka qenë Automatika dhe ELEKTROTEKNIKA, del që diploma e ofruar me drejtimin Automatikë me ELEKTRONIKË të mos jetë sipas kërkesës së AK-së prandaj bazuar në nenin 59 të LPP-së del të jetë e ndryshme, çka e bënë atë të

papranueshme ndërsa OE në fjalë e bënë të papërgjegjshëm. Vlen të thuhet se termi elektronikë dallon me termin elektroteknikë. Në këtë rast kjo e dyta i përgjigjet plotësisht natyrës së projektit dhe është më e afërt me diplomën që kemi dorëzuar ne se sa atë që ka dorëzuar OE i shpallur fitues.

Përpos kësaj, në listën e stafit që është kërkuar të dorëzohet si e nënshkruar dhe e vulosur, nuk figuron fare emri i personit për të cilin është dorëzuar diploma. Ja si dukej kërkesa e AK-së::

Tani ja si duket edhe lista e stafit që ky OE ka dorëzuar:

Në këtë listë mungon inxhinieri BEKIM (Ibrahim) HAMITI prandaj mos paraqitja e listës së stafit me emrat real ashtu siç e ka kërkuar AK-ja, e bënë OE në fjalë të papërgjegjshëm në pikën e kërkesës së tillë. AK është dashur ta eliminoj këtë OE si të papërgjegjshëm e jo ta shpallë atë si fitues!

Mangësia 2: AK kishte kërkuar që OE jenë të përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së. Kjo kërkesë ishte parashtruar tek pika 6 e FDT-së.

Sipas ligjit dhe interpretimit të KRPP-së Nr. 6 të datës 22.11.2022, OE të cilët kanë borxhe në ATK por janë marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste, pranohen si të përshtatshëm me kusht që marrëveshja e tillë me ATK-në të jetë me datë më të hershme se sa data e njoftimit për kontratë. Ky OE nuk e ka dëshmuar këtë andaj nisur nga kërkesat e ligjit por edhe nga interpretimi, OE del të jetë i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm edhe në drejtim të nenit 65 të LPP-së. Ja si duket dëshmia që tregon se ky OE ka borxhe të pashlyera në ATK:

Ky OE realisht nuk është dashur të shpallet fitues pa e dëshmuar se marrëveshja është lidhur para njoftimit për kontratë dhe këtu mund të themi lirisht se AK përpos shkeljes së nenit 65 të LPP-së, ka shkelur edhe nenin 59 të LPP-së.

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së edhe me rastin e cilësimit të tenderit tonë si të papërgjegjshëm. Arsytimi i AK-së për eliminimin tonë duket kështu:

Kjo nuk qëndron fare as për arsyen e mungesës së inxhinierin e as për pajisjen. AK në kërkesën për inxhinierin kishte lënë dy mundësi të plotësimit të këtij kriteri ku përpos kësaj mundësia e dytë si kërkesë e plotësimit nuk ishte e hartuar si duhet sepse drejtimi që AK kishte përcaktuar nuk ekziston dhe nuk ka ekzistuar asnjëherë si drejtim në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Kosovës. Ja si duket kërkesa e tillë:

Sipas kësaj që shihet AK e ka ndarë kërkesë në dy mundësi ku mundësia e parë e plotësimit të kësaj kërkesë është: Min Nje inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes sistemi 5 vjeçar apo master dega Automatika dhe Elektroteknika minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Në aspektin gjuhësor dhe atë të drejtshkrimit, AK e ka ndarë kërkesën e tillë në dy pjesë ku secila pjesë e ofron nga një mundësi të plotësimit të sajë pasi që pjesët fjalisë janë të lidhura me lidhësen “apo”. Nisur nga kjo del që ne e kemi plotësuar pjesën e parë duke dorëzuar një person që është inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me sistemin 5 vjeçar. Kjo kërkesë shihet se është plotësuar nga ana jonë andaj mospranimi i diplomës së tillë dhe cilësimi i tenderit tonë si i papërgjegjshëm përbën shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së nga ana e AK- së. Ja si duket diploma që ne kemi paraqitur:

Bazuar në këtë që po shihet, diploma që ne e kemi paraqitur i përgjigjet drejtimit të pjesës së parë të kërkesës që AK e ka lënë si mundësi të dyfishtë por edhe gjysmës së pjesës së dytë aty ku është kërkuar dega elektroteknikë. Ja edhe një sqarim më i detajuar për këtë qëllim:

Nga ky formulim, fjala "apo" përfaqëson dhe shprehë një zgjedhje midis dy opsioneve të vlefshme të kualifikimit ku gjithashtu është një mundësi alternative dhe jo një kërkesë detyruese. Këtu realisht është kërkuar një inxhinier me Diplome 5-vjeçare në elektroteknikë (sistemi i vjetër), apo një Master në degët Automatikë dhe Elektroteknikë ku si rrjedhojë e kësaj, inxhinieri që ne kemi paraqitur është plotësisht në përputhje me njërin nga mundësitë që është lënë në kërkesën e tenderit.

Konkretisht:

Në dokumentacionin e tenderit, termi "Automatike dhe Elektroteknikë" lidhet vetëm me opsionin e masterit dhe nuk i përjashton diplomat në elektroteknikë të sistemit 5-vjeçar.

Kërkesa është e hapur me përdorimin e lidhëses "apo" dhe kjo do të thotë që kërkesa pranon Inxhinier të Diplomuar në Elektroteknikë (sistemi 5-vjeçar), apo Master në Automatikë dhe Elektroteknikë. Kjo jep mundësi dhe më shumë fleksibilitet për çka pranon kualifikime të ndryshme.

Pra me që kërkesa e AK-së ishte e tillë, del që diploma që ne kemi paraqitur e plotëson kushtin sipas pjesës së parë të kërkesës. Cilësimi i tenderit tonë si të papërgjegjshëm është shkelje e plotë e nenit 59 të LPP-së nga ana e AK-së e sidomos kur marrim parasysh faktin që kërkesa nuk ishte e hartuar si duhet, faktin që as OE i shpallur fitues nuk e plotëson në tërësi ashtu siç e ka përcaktuar AK-ja si dhe faktin që tenderi jonë posedon çmimin më të ulët. Aplikimi i standardit të dyfishtë dhe aplikimi i kërkesës në mënyrë selektive nga ana e AK-së e shtynë këtë të fundit në shkelje të plotë edhe të nenit 7 dhe 59 të LPP-së.

Përpos kësaj kjo shihet edhe tek kërkesa përkatësisht tek pjesa e dytë e fjalisë ku AK ka vendosur një kriter që si mundësi nuk ekziston dhe nuk ka ekzistuar asnjë herë në historinë e Universitetit të Kosovës. Nisur nga kjo AK është dashur që të bëjë vlerësim të barabartë për të gjithë OE nga ku del që ne do duhej të shpalleshim si fitues.

Drejtimi Automatikë dhe Elektroteknikë nuk ka ekzistuar asnjëherë dhe nuk ekziston as në ditët e sotme. Ja si duken drejtimit e atëhershme dhe të tashme në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Kosovës:

Drejtimet e atëhershme (para vitit 2000) ishin kështu:

1. Sisteme elektroenergjetike
2. Elektroenergjetikë industriale
3. Kompjuterikë me telekomunikacion
4. AUTOMATIKE ME ELEKTRONIKË

Drejtimet e tashme (pas vitit 2000) janë kështu:

Pra po shihet se asnjëri nga drejtimet nuk i përgjigjet saktë kërkesës së AK-së andaj AK duhet të bëjnë pranim të barabartë të diplomave për secilin tenderues me standardin e njëjtë të vlerësimit.

Përpos kësaj neve na ka eliminuar edhe për goja se nuk e kemi plotësuar kriterin për pajisjen kamion me kran. Ne e kemi pasur këtë pajisje në listën e pajisjeve andaj AK është dashur që në përputhje me nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së, të na kërkoj sqarime. AK ka vepruar dhe ka aplikuar mundësinë e tillë në mënyrë selektive pasi që njërit nga OE që ishte konkurrent në këtë tender ia ka dhënë mundësinë e sjelljes së dëshmimeve që i mungonin për pajisjet që i kishte vetëm në listën ndërsa neve nuk na e ka ofruar këtë mundësi. Kjo përpos që përbënë shkelje të nenit 59 dhe 72 të LPP-së, përbënë edhe shkelje të nenit 7 të LPP-së pasi që nuk na ka trajtuar si të barabartë me tenderuesit tjerë. Më saktësisht, AK i ka kërkuar OE ITEM EL SHPK që ta plotësoj tenderin me dëshmitë që i mungonin për pajisjet e listës ndërsa neve jo. Ja dëshmia:

Krejt këto veprime të kundërligjshme dhe jo etike të AK-së e shtynë këtë të fundit në shkeljen e plotë të nenit 59 të LPP-së i cili decidivisht flet për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në mënyrë të drejtë dhe të pa anshme. Vlen të thuhet edhe kjo se AK në refuzimi e kërkesës për rishqyrtim ka dhënë disa arsyetime të pabazuara dhe jo ligjore duke u munduar të kamufltoj veprimet e veta të kundërligjshme në përzgjedhjen e një fituesi edhe pse ai ishte tenderues i papërgjegjshëm.

Ne e inkurajojmë ekspertin shqyrtues që gjatë trajtimit të pretendimeve tona të merr parasysh ato dhe ta kryej trajtimin në përputhje me rregullat dhe dispozitat ligjore të prokurimit si dhe me në përputhje me rregulloren e punës së OSHP-së për çka kemi besim se do të na aprovohet ankesa si e bazuar.

3. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi gjatë vlerësimit nuk ka respektuar kriterin e vlerësimit që ishte tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët të poentuar. E themi këtë sepse fillimisht po tenton ta shkelë pjesën e parë të kriterit pasi që tenderuesi i shpallur fitues del të jetë i papërgjegjshëm, mandej po e shkelë edhe pjesën e dytë të kriterit ku ne jemi me çmim më të ulët se sa tenderuesi i shpallur fitues. Krejt kjo tregon se AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka shkelur nenin 60 të LPP-së,

4. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat veta të caktuara tek FDT. AK ka vendosur kërkesa teknike që lidheshin me nenin 69 të LPP-së por që nuk i ka zbatuar si duhet gjatë procesit të vlerësimit. Disa prej këtyre kriterëve i ka anashkaluar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderit të shpallur fitues. Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kriterëve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69 të LPP-së të përcaktuara tek FDT-ja, kemi të bëjmë edhe me favorizim të hapur të OE që AK e ka shpallur fitues.

5. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që neve nuk na ka kërkuar sqarime për dëshmitë e pajisjeve që i kishim në listë por që na mungonin në tender. Kërkesën për sqarime të tilla AK e ka bërë tek disa nga tenderuesit konkurrent por qëllimisht neve na ka diskriminuar dhe nuk na ka kërkuar sqarimet e tilla. Me që sipas nenit 59.4 por edhe sipas nenit 72 të LPP-së, kur një dëshmi mungon, është e gabuar apo nuk është e kuptueshme AK duhet të kërkoj sqarime shtesë, del që këtë është dashur ta bëje edhe tek tenderi jonë sepse ofrimi i dëshmimeve të tilla nuk krijon ndryshim substancial dhe se dëshmitë e tilla dëshmojnë objektivisht se kanë ekzistuar edhe para hapjes publike. Mos kërkesa për sqarim, e shtynë AK-në në shkelje të plotë të nenit 72 të LPP-së por edhe në shkelje të nenit 7 të LPP-s për trajtim jo të barabartë të tenderuesve.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi “ANESI” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me AK ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së. Pas gjithë këtyre sqarimeve, dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar duke marrë këtë: V E N D I M te APROVOHET si e bazuar ankesa e OE “ANESI SH.P.K.” lidhur me tenderin “Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Qytet dhe Fshatra” i iniciuar nga KOMUNA E LIPIJANIT. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës i publikuar nga AK - KOMUNA E LIPIJANIT dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që Fitues të shpallej OE “ANESI SH.P.K.” Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “ANESI” SH.P.K., Grup i Operatorëve Ekonomik e O.E ANESI SH.P.K.Gazmend Zajmi Nr 36, Prishtinë ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim, të dt. 16.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Qytet dhe Fshatra, me nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1, kundër vendimi të Autoritetit Kontraktues për shpërbllim me kontratë, të datës; 09.01.2025.

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Sa i përket pretendimit të tenderuesit ankues se nuk kapërbush kriterin sipas kërkesës në mardhenie pune një ing siq është kërkuar në dosje te tenderit nuk qëndron për arsye siq edhe ju vet e keni nënvizuar shihet se diploma është me titull: automatikë me eelektronikë.

Sa i përket pretendimit se tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk e ka sjellë vertetimin e ATK-së siq kërkohet në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit as ky pretendim nuk qëndron për arsye se në dosje të tenderit nuk specifikohet se nëse është në marrveshje duhet të bashkangjitet marrëveshja, ndërsa sa i përket se është në marrveshje për pagim të borgjit në rastet e tilla ne kemi pasur rast edhe më heret dhe për këtë jemi konsultuar drejt për drejt me ATK dhe na është rekomanduar se nëse na paraqitet një vertetim se një opetar ekonomik është në marrëveshje për pagimin e borgjit të ATK-së atëherë ky duhet të pranohet si i mirëqenë.

Sa përket pretendimit se nuk posedon kamion me vinq nuk qëndron marrveshjen dhe librezën e kësaj pajisje do ti bashkangjiten këtij vendimi për të dëshmuar se ekziston .

Sa i përket pretendimit se ju i keni plotësuar kriteret e njoftimit për kontratë se keni në stafm e juaj ing te elektoteknikës por siq është cekë nuk është drejtimi i automatikës dhe po mundoheni që të krijoni paqartësi duke përdorën fjalën (apo) kjo fjalë për sistemin pesë vjeqar apo master, dhe vazhdon drejtimi automatike dhe elektroteknikë.

Sa i përket pretendimit të tjetër se operatori i shpallur fitues nga AK ka çmime jo normalishtë të ulta ky pretendim nuk qëndron për arsye se të gjitha ofertat e pranuar kanë laramani të çmimeve në pozicione të ndryshme dhe krahasuar me ofertën e tenderuesit ankues është më afër çmimeve të tregut.

Pretendimi: Dallimi i çmimeve qe ky OE ka ofruar në krahasim me çmimet e tregut janë jashtëzakonisht i iarta. Ky pretendim nuk qëndron sepse asnjë çmim nuk është më i lartë se qmimet e ofruara nga tenderuesi ankues.

Sa i perkete pretendimit tjetër ne lidhje me Nenin 7- Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi dhe transpareca, ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues perkatesishte komisioni i vleresimit konsideron se ka vepruar konforme kerkesave dhe deshmive te kërkuara ne baze te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate per kete aktivitet te prokurimit, si dhe duke i'u permbajtur dispozitave ligjore te LPP-se. AK me kete rast konsideron se per kete aktivitet te prokurimit ka nxjerr vendim te drejt, te arsyeshem dhe meritor duke i'u përmbajtur nenit 7, paragrafeve 1, 2 dhe 4 te LPP-se, i cili garanton trajtim te barabarte, jodiskriminues, transparente dhe konkurrues ne mes te Operatoreve Ekonomik.

Sa i përketë pretendimit tjetër ne lidhje Neni 59 - Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, edhe ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues ne baze te dispozitave ligjore te LPP-se perkatesishte nenit 59 ka kerkuar sqarime shtese me ane te letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit nga te gjithë Operoret Ekonomik mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve dhe duke ju përmbajtur dispozitave ligjore te LPP-se ne baze te neni 59 te këtij ligji.

Sa i përketë pretendimit tjetër ne lidhje Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se AK ne baze te paragrafit 1.1 te këtij neni ka rekomanduar për kontrate OE me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Item EL” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së pasi që gjatë administrimit me këtë procedurë nuk ka luajtur aspak rol aktiv që shpenzimi i parasë publike të bëhet në mënyrë efikase, dhe transparente si dhe nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. E themi këtë sepse AK po tenton ta shpërblej me kontratë një OE i cili edhe pse posedon çmimin më ulët në krahasim me neve, i njëjti nuk e plotëson kriterin për njërin nga inxhinierët e kërkuar nga AK si dhe posedon shumë nga çmimet nëpër pozicione si çmime jo-normalisht të ulëta me nga vetëm 0.10€. Përpos kësaj ky OE posedon edhe borxhe në ATK dhe se nuk ka dëshmuar fare se marrëveshja për shlyerjen e borxheve është me datë para njoftimit për kontratë. Në bazë të kësaj po shihet se AK e ka favorizuar OE në fjalë dhe e ka shpërblyer me kontratë në kundërshtim me të gjitha rregullat që flasin për vlerësimin e tenderuesve duke u bazuar ekskluzivisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat tjera ligjore.

Vlen të thuhet se në të njëjtën kohë neve na ka eliminuar pa asnjë të drejtë ligjore edhe pse i kemi plotësuar kriteret e kërkuara për stafin (inxhinierin) ngjashëm sikurse OE që AK e ka shpallur fitues.

Nisur nga krejt kjo, lirisht mund të themi AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 7 të LPP-së gjatë këtij procesi të vlerësimit përkatësisht të përzgjedhjes së fituesit.

2. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne konstatojmë se AK ka shkelur nenin në fjalë për faktin se OE ELEKTRIKA MONT SH.P.K. nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për Inxhinierin e Diplomuar të Elektroteknikës sipas kërkesës së AK-së, nuk ka dëshmuar se marrëveshja me ATK është e lidhur para datës së njoftimit për kontratë si dhe shumë nga çmimet nëpër pozicione i ka çmime jo-normalisht të ulëta. Tani në vazhdim po pasqyrojmë mangësitë e tilla duke paraqitur pretendimet tona për mos plotësimin e kërkesave të dosjes së tenderit ashtu siç AK i kishte kërkuar dhe ashtu siç e kërkon edhe ligji dhe rregullat tjera të prokurimit publik Mangësia 1: AK kishte kërkuar ndër të tjera që OE të posedojnë në stafin e tyre një Inxhinier me një profesion dhe përvojë specifike. Kërkesa e tillë e AK-së duket kështu:

OE në fjalë nuk e ka plotësuar këtë kriter saktë qysh e ka kërkuar AK sepse në vend të inxhinierit me drejtim “AUTOMATIKA dhe ELEKTROTEKNIKA” ka paraqitur inxhinierin me drejtimin AUTOMATIKË ME ELEKTRONIKË”. Me që neve na ka eliminuar vetëm për këtë kriter atëherë ne po e kundërshtojmë pranimin edhe të kësaj diplome me që edhe kjo nuk është saktë sipas kërkesës së AK-së. Nisur nga standardi që AK ka aplikuar tek tenderi jonë e që i njëjti standard sipas ligjit duhet aplikuar edhe tek secili konkurrent, del që OE ELEKTRIKA MONT SH.P.K. nuk e ka plotësuar kërkesën e tillë. Ja si duket diploma e ofruar nga ky OE:

Me që kërkesa e AK-së për drejtimin ka qenë Automatika dhe ELEKTROTEKNIKA, del që diploma e ofruar me drejtimin Automatikë me ELEKTRONIKË të mos jetë sipas kërkesës së AK-së prandaj bazuar në nenin 59 të LPP-së del të jetë e ndryshme, çka e bënë atë të papranueshme ndërsa OE në fjalë e bënë të papërgjegjshëm. Vlen të thuhet se termi elektronikë dallon me termin elektroteknikë. Në këtë rast kjo e dyta i përgjigjet plotësisht natyrës së projektit dhe është më e afërt me diplomën që kemi dorëzuar ne se sa atë që ka dorëzuar OE i shpallur fitues.

Përpos kësaj, në listën e stafit që është kërkuar të dorëzohet si e nënshkruar dhe e vulosur, nuk figuron fare emri i personit për të cilin është dorëzuar diploma. Ja si dukej kërkesa e AK-së:

Tani ja si duket edhe lista e stafit që ky OE ka dorëzuar:

Në këtë listë mungon inxhinieri BEKIM (Ibrahim) HAMITI prandaj mos paraqitja e listës së stafit me emrat real ashtu siç e ka kërkuar AK-ja, e bënë OE në fjalë të papërgjegjshëm në pikën e kërkesës së tillë. AK është dashur ta eliminoj këtë OE si të papërgjegjshëm e jo ta shpallë atë si fitues!

Mangësia 2: AK kishte kërkuar që OE jenë të përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së. Kjo kërkesë ishte parashtruar tek pika 6 e FDT-së.

Sipas ligjit dhe interpretimit të KRPP-së Nr. 6 të datës 22.11.2022, OE të cilët kanë borxhe në ATK por janë marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste, pranohen si të përshtatshëm me kusht që marrëveshja e tillë me ATK-në të jetë me datë më të hershme se sa data e njoftimit për kontratë. Ky OE nuk e ka dëshmuar këtë andaj nisur nga kërkesat e ligjit por edhe nga interpretimi, OE del të jetë i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm edhe në drejtim të nenit 65 të LPP-së. Ja si duket dëshmia që tregon se ky OE ka borxhe të pashlyera në ATK:

Ky OE realisht nuk është dashur të shpallet fitues pa e dëshmuar se marrëveshja është lidhur para njoftimit për kontratë dhe këtu mund të themi lirisht se AK përpos shkeljes së nenit 65 të LPP-së, ka shkelur edhe nenin 59 të LPP-së si dhe interpretimin e KRPP-së.

Mangësia 3: Kjo mangësi lidhet me çmimet jo-normalisht të ulëta të ofruara nga OE i shpallur fitues ku disa prej tyre shihen hapur se janë shumë më të ulëta se sa çmimet e tregut. Këto çmime jo-normalisht të ulëta ky OE i posedon në disa nga pozicionet e listës së çmimeve për të cilat është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm sepse nuk ekziston asnjë mundësi teorike e as praktike që të mund të liferohen me çmimin e tillë. Në vazhdim po i paraqesim vetëm disa nga çmimet e tilla që ndodhen tek tabela e dytë dhe e tretë e listës së çmimeve:

Paramendoje, artikullin që në treg e posedon çmimin 55.00 euro, e ka ofertuar me vetëm 0.10€.

Ky OE ligjërisht është dashur të konsiderohet i papërgjegjshëm për të gjitha këto mangësi që i posedon në tenderin e tij e jo të shpërblehet në asnjë formë me kontratë.

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së edhe me rastin e cilësimit të tenderit tonë si të papërgjegjshëm. Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë duket kështu:

Kjo nuk qëndron fare dhe si arsye është plotësisht e pabazuar. AK në kërkesën e tyre për inxhinierin kishte lënë dy mundësi të plotësimit të këtij kriteri ku përpos kësaj mundësie e dytë si kërkesë e plotësimit nuk ishte e hartuar si duhet sepse drejtimi që AK kishte përcaktuar nuk ekzistonte dhe nuk ka ekzistuar asnjëherë si drejtim në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Kosovës. Ja si duket kërkesa e tillë:

Sipas kësaj që shihet AK e ka ndarë kërkesë në dy mundësi ku mundësia e parë e plotësimit të kësaj kërkesë është: Min Nje inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes sistemi 5 vjeçar apo master dega Automatika dhe Elektroteknika minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Në aspektin gjuhësor dhe atë të drejtshkrimit, AK e ka ndarë kërkesën e tillë në dy pjesë ku secila pjesë e ofron nga një mundësi të plotësimit të sajë pasi që pjesët e fjalisë janë të lidhura me lidhësen "apo". Nisur nga kjo del që ne e kemi plotësuar pjesën e parë duke dorëzuar një person që është inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me sistemin 5 vjeçar. Kjo kërkesë shihet se është plotësuar nga ana jonë andaj mospranimi i diplomës së tillë dhe cilësimi i tenderit tonë si i papërgjegjshëm përbën shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së nga ana e AK-së. Ja si duket diploma që ne kemi paraqitur:

Bazuar në këtë që po shihet, diploma që ne e kemi paraqitur i përgjigjet drejtimit të pjesës së parë të kërkesës që AK e ka lënë si mundësi të dyfishtë por edhe gjysmës së pjesës së dytë aty ku është kërkuar dega elektroteknikë. Ja edhe një sqarim më i detajuar për këtë qëllim:

Nga ky formulim, fjala "apo" përfaqëson dhe shprehë një zgjedhje midis dy opsioneve të vlefshme të kualifikimit ku gjithashtu është një mundësi alternative dhe jo një kërkesë detyruese. Këtu realisht është kërkuar një inxhinier me Diplome 5-vjeçare në elektroteknike (sistemi i vjetër), apo një Master në degët Automatikë dhe Elektroteknikë ku si rrjedhojë e kësaj, inxhinieri që ne kemi paraqitur është plotësisht në përputhje me njërin nga mundësitë që është lënë në kërkesën e tenderit.

Konkretisht:

Në dokumentacionin e tenderit, termi "Automatike dhe Elektroteknikë" lidhet vetëm me opsionin e masterit dhe nuk i përjashton diplomat në elektroteknikë të sistemit 5-vjeçar.

Kërkesa është e hapur me përdorimin e lidhëses "apo" dhe kjo do të thotë që kërkesa pranon Inxhinier të Diplomuar në Elektroteknikë (sistemi 5-vjeçar), apo Master në Automatikë dhe Elektroteknikë. Kjo jep mundësi dhe më shumë fleksibilitet për çka pranon kualifikime të ndryshme.

Pra me që kërkesa e AK-së ishte e tillë, del që diploma që ne kemi paraqitur e plotëson kushtin sipas pjesës së parë të kërkesës. Cilësimi i tenderit tonë si të papërgjegjshëm është shkelje e plotë e nenit 59 të LPP-së nga ana e AK-së e sidomos kur marrim parasysh faktin që kërkesa nuk ishte e hartuar si duhet, faktin që as OE i shpallur fitues nuk e plotëson në tërësi ashtu siç e ka përcaktuar AK-ja si dhe faktin që tenderi jonë posedon çmimin më të ulët. Aplikimi i standardit të dyfishtë dhe aplikimi i kërkesës në mënyrë selektive nga ana e AK-së e shtynë këtë të fundit në shkelje të plotë edhe të nenit 7 dhe 59 të LPP-së.

Përpos krejt kësaj kjo shihet edhe tek kërkesa përkatësisht tek pjesa e dytë e fjalisë ku AK ka vendosur një kriter që si mundësi nuk ekziston dhe nuk ka ekzistuar asnjë herë në historinë e Universitetit të Kosovës. Nisur nga kjo AK është dashur që të bëjë vlerësim të barabartë për të gjithë OE nga ku del që ne do duhej të shpallehim si fitues.

Drejtimi Automatikë dhe Elektroteknikë nuk ka ekzistuar asnjëherë dhe nuk ekziston as në ditët e sotme. Ja si duken drejtimet e atëhershme dhe të tashme në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Kosovës:

Drejtimet e atëhershme (para vitit 2000) ishin kështu:

1. Sisteme elektroenergjetike
2. Elektroenergjetikë industriale
3. Kompjuterikë me telekomunikacion
4. AUTOMATIKE ME ELEKTRONIKË

Drejtimet e tashme (pas vitit 2000) janë kështu:

Pra po shihet se asnjëri nga drejtimet nuk i përgjigjet saktë kërkesës së AK-së sepse AK e ka ngatërrua fjalën Elektronikë me fjalën Elektroteknikë që në aplikim dallojnë shumë, andaj në rastin e tillë AK duhet të bëjnë pranim të barabartë të diplomave për secilin tenderues që ka paraqitur një inxhinier apo master të elektroteknikës duke aplikuar standardin e njëjtë të vlerësimit.

Këtu duam të theksojmë edhe faktin se edhe të gjithë tenderuesit tjerë që posedojnë çmimin ofertues më të ulët se ne janë të papërgjegjshëm gjë të cilën e kemi vërejtur gjatë analizimit të tenderëve të tyre por me që në rastin konkret nuk janë palë e kontestit, nuk po ndalemi me elaborimin e secilit prej tyre.

Krejt këto veprime të kundërligjshme dhe jo etike të AK-së e shtyjnë këtë të fundit në shkeljen e plotë të nenit 59 të LPP-së i cili decidivisht flet për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në mënyrë të drejtë dhe të pa anshme. Vlen të thuhet edhe kjo se AK në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ka dhënë disa arsye të pabazuara dhe jo ligjore duke u munduar të kamuflojë veprimet e veta të kundërligjshme në përzgjedhjen e një fituesi edhe pse ai ishte tenderues i

papërgjegjshëm.

Ne e inkurajojmë ekspertin shqyrtues që gjatë trajtimit të pretendimeve tona të merr parasysh këto që kemi theksuar në ankesë dhe ta kryej trajtimin në përputhje me rregullat dhe dispozitat ligjore të prokurimit si dhe me në përputhje me rregulloren e punës së OSHP-së për çka kemi besim se ankesa do të na aprovohet si e bazuar.

3. AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët pasi që nuk i ka trajtuar fare çmimet jo-normalisht të ulëta të OE që e ka shpallur fitues. Ky OE ka ofertuar me çmime spekulative pasi që në disa pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta (0.10€) ndërsa në disa pozicione ka ofruar edhe çmime shumë të larta.

Në vazhdim po e paraqesim si të pjesshme listën e çmimeve të OE të shpallur fitues nga ku mundeni të shihni edhe vet se si janë ofruar çmime spekulative në këtë rast:

Nisur nga kjo shihet se AK ka qenë i detyruar të i trajtoj këto çmime sipas ligjit dhe rregullores përkatëse. Mos veprimi i AK-së dhe mos trajtimi i tenderit të tillë sipas rregullave për trajtimin e Çmimeve jo-normalisht të Ulëta, konsiderohet shkelje e plotë e nenit 61 të LPP-së si dhe shkelje e plotë edhe e nenin 41 të RRPP-001/2022. Çmimet e tilla e bëjnë komplet të papërgjegjshëm tenderin në fjalë si dhe e vendosin AK-në para një rreziku të madh për dështim të kontratës dhe njëherit krijojnë keqpërdorim enorm të parasë publike. Dallimi i çmimeve që ky OE ka ofruar në krahasim me çmimet e tregut janë jashtëzakonisht të larta, dhe nëse AK nuk merr masa në përmirësimin e procesit të vlerësimit, atëherë ne do ta dërgojmë lëndën prapë në OSHP duke e arsyetuar secilin pretendim për çmimet me fatura të marrura nga dyqanet e specializuara për këto lloje të artikujve.

4. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat veta të caktuara tek FDT. AK ka vendosur kërkesa teknike që lidheshin me nenin 69 të LPP-së por që nuk i ka zbatuar si duhet gjatë procesit të vlerësimit. Disa prej këtyre kriterëve i ka anashkaluar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderit të shpallur fitues. Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kriterëve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69 të LPP-së të përcaktuara tek FDT-ja, kemi të bëjmë edhe me favorizim të hapur të OE që AK e ka shpallur fitues.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi "Item EL" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me AK ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së, AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së Pas gjithë këtyre sqarimeve, dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar duke marrë këtë: V E N D I M APROVOHET si e bazuar ankesa e OE "Item EL SH.P.K." lidhur me tenderin "Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra" i iniciuar nga KOMUNA E LIPIJANIT. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës i publikuar nga AK - KOMUNA E LIPIJANIT dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që Fitues të shpallej OE "Item EL SH.P.K." Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE "Item EL" SH.P.K., Grup i Operatorëve Ekonomik e " Item EL " SH.P.K. Rr.Burim Vitia, Prishtinë, ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim, të dt. 16.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet

dhe Fshatra, me nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1, kundër vendimi të Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontratë, të datës; 09.01.2025.

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit të tenderuesit ankues se nuk ka në mardhenie pune një ing siq është kërkuar në dosje të tenderit nuk qëndron për arsye siq edhe ju vet e keni nënvizuar shihet se diploma është me titull automatikë me elctromke.

Sa i përket pretendimit se ju i keni plotësuar kritcret e njoftimit për kontratë se keni në stafin e juaj ing te elektoteknikës por siq është cekë nuk është drejtimi i automatikës dhe po mundoheni që të krijoni paqartësi duke përdorën fjalën (apo) kjo fjalc për sistemin pesë vjeqar apo master, dhe vazhdon drejtimi automatike dhe elektroteknikë.

Sa i përket pretendimit se tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk e ka sjellë vertetimin e ATK-së siq kërkohet në njoftim per kontratë dhe dosje të tenderitas ky pretendim nuk qëndron për arsye se në dosje të tenderit nuk specifikohet se nëse është në marrveshje duhet te bashkangjitet marrveshja, ndërsa sa i përket se është në marrveshje për pagim të borgjit në rastet e tilla ne kemi pasur rast edhe më heret dhe jemi konsultuar drejt për drejt me ATK dhe na është rekomanduar se nëse na paraqitet një vertetim se një opetar ekonomik është në marrveshje për pagimin e borgjit të ATK-së atëherë ky duhet te pranohet si i mireqenë.

Sa i përket pretendimit tjetër se operatori i shpallur fitues nga AK ka çmime jo normalishtë të ulta ky pretendim nuk qëndron për arsye se të gjitha ofertat e pranura kanë laramani të çmimeve në pozicione të ndryshme.

Sa i perkete pretendimit tjetër ne lidhje me Nenin 7- Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi dhe transparenca, ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues perkatesishte komisioni i vleresimit konsideron se ka vepruar konforme kerkesave dhe deshmive te kërkuara ne baze te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate per kete aktivitet te prokurimit, si dhe duke i'u permbajtur dispozitave ligjore te LPP-se. AK me kete rast konsideron se per kete aktivitet te prokurimit ka nxjerr vendim te drejt, te arsyeshem dhe meritore duke i'u permbajtur nenit 7, paragrafeve 1, 2 dhe 4 te LPP-se, i cili garanton trajtim te barabarte, jodiskriminues, transparentc dhe konkurrues ne mes te Operatoreve Ekonomik.

Sa i përket pretendimit tjetër ne lidhje Neni 59 - Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, edhe ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues ne baze te dispozitave ligjore te LPP-se perkatesishte nenit 59 ka kerkuar sqarime shtese me ane te letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit nga te gjithë Operoret Ekonomik mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve dhe duke ju permbajtur dispozitave ligjore te LPP-se ne baze te neni 59 te këtij ligji.

Sa i përket pretendimit tjetër ne lidhje Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, pretendimi juaj nuk qëndron per arsye se AK ne baze te paragrafit 1.1 te këtij neni ka rekomanduar per kontrate OE me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me pëipikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi shyrtues i prokurimit me datë 28.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me nr. 0069/2025, me datën 27.01.2025 ka autorizuar

ekspertin per ankesën me nr.0070/2025 si dhe me datën 29.01.2025 ka autorizuar ekspertin per shyrtingin e pretendimeve ankimore per ankesën 0072/2025.

Lidhur me ankesën nr. 0069/2025 me datë 04.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2025/0069 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 0070/2025 me datë 04.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me Nr. 2025/0070 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 0072/2025 me datë 04.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me Nr. 2025/0072 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës me nr.0069/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertës shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertës shqyrtuese.

Raportin e ekspertizës me nr.0070/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertës shqyrtuese, ndërsa OE Pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Raportin e ekspertizës me nr.0072/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertës shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “TALA ENGINEERING” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0069 ka vlerësuar si në vijim:

Tenderuesi Ankues, Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K & CONSTRUCTION GROUP SHPK & Muharrem Hoti B.i. Prishtinë, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 13.01.2025, përderisa AK me datë 16.01.2025 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës

për rishqyrtim. Tenderuesi Ankues, deklaroi se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK-KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN të datë 09.01.2025 dhe PRETENDON se AK, me rastin e vlerësimit të tenderëve dhe të shpalljes së fituesit për këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me Dispozitat e LPP-së dhe me dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Eksperti shqyrtues, sipas autorizimit 2025/0069, pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar në shkresat e lendes së trajtuar ka konstatuar dhe sqaron me sa vijon:

I. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE, për tenderuesin ANKUES, Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K & CONSTRUCTION GROUP SHPK & Muharrem Hoti B.i. Prishtinë

PRETENDIMI 1. I TENDERUESIT ANKUES Me datën 09.01.2025 përmes e-prokurim@rks-gov.net nga AK kemi pranuar „Leter Standarde për tenderuesinë e eliminuar “” në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: „Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra ” me nr. prokurimi: 613-24-7288-2-1-1

Përgjigje në pretendimet e lartë cekura Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues duke vepruar në kuptim të nenit 16 paragrafit 2 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, dhe në pajtim me nenin 105.2.16 të LPP-së e njofton panelin shqyrtues se palët janë të njëjta (AK-OE ankues) objekti i këtij pretendimi është i njëjtë dhe është shqyrtuar më parë me vendimin nr. 2024/0962, andaj për këto arsye, i propozon panelit shqyrtues që këtë çështje (lidhur me ofertën e tenderuesit ankues, Grupi i OE, TALA ENGINEERING SH.P.K & CONSTRUCTION GROUP SHPK & Muharrem Hoti B.i. Prishtinë) ta trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, në këtë pikë pretendimi i tenderuesit ankues është i pabazuar.

II. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË TENDERUESIT ANKUES, për tenderuesin e rekomanduar për kontratë “ELEKTRIKA - MONT” SH.P.K, Lipjan

PRETENDIMI 1. I TENDERUESIT ANKUES Nenin 61 (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët), Autoriteti kontraktues rekomandon për kontratë një OE me cmime minimale të gjitha nga 10 cent dhe 1 euro, por nuk i kërkon as deshmi sipas nenit 41 Tenderet Jo-Normalisht të Ulët, 41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët".

Perveq, Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët”. duke u bazuar në vendimin e OSHP- se të datës 16.12.2024 në nr 2024/0962, dhe raporteve të eksperteve AK duhet të kërkon edhe dërgatë doganor si deshmi që OE ka material të nevojshëm për kryerjen e punimeve me këto cmime.

Si është e mundur që në ta eliminon në për cmime të ulëta ndërsa të rekomandoni për kontratë një OE me cmime të njëjta.

Pretendimet Ankimore per Operatorin Ekonomik te përgjegjshem te rekomanduar per kontrate ELEKTRIKA-MONT SHPK.

Ne baze te vendimit te OSHP-se 2024/0962 dhe dy Raporteve te Eksperteve, duke prolonguar per tenderit me cmime jonormalisht te uleta, AK ka rekomanduar per kontrate nje OE me cmime jashtzakonisht te uleta, e cila tregon bindshem se duke krahasuar me cmime te tregut këto punimeve nuk mund te kryhen.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur -Nenin 61(Tenderët Jo-Normalisht të Ulët),) Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesi ankues, se nuk është zbatuar si duhet 61 të LPP-së dhe nenin 41 te Rregullores nr.001/2022 për PP me rastin e vlerësimit të tenderëve (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) nga Autoriteti Kontraktues, është plotësisht i bazuar, sepse në ofertën e Tenderuesit të shpallur fitues, "ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan kam konstatuar se kemi të bëjmë me tender jo normalisht të ulët në krahasim me objektin e kontratës dhe krahasimin e çmimeve me ofertuesit tjerë dhe me çmimet e tregut për këtë shërbim dhe furnizime, pasi që i në ofertën totale përmbush vetëm 2 kushtet si vijon:

Neni 3 Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:

i.çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii.janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Eksperti shqyrtues, pas analizës dhe llogaritjes së ofertave financiare të tenderuesve pjesëmarrës, ka konstatuar se AK gjate vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 61 të LPP-se, të ofertës së Tenderuesit të rekomanduar për kontratë, "ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan si ofertë TOTALE i përmbush dy kushtet dhe si rrjedhojë konsiderohet tender jo normalisht i ultë, kurse sa i përket çmimeve për njësi-artikull i përmbush në tërësi të gjitha kushtet ligjore nga neni nenin 41 pika 6 te Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik dhe si rrjedhojë mund te konsiderohet dhe të trajtohet oferta jo normalisht të ulëta dhe mund të refuzohen si tender jo-normalisht i ulët.

Eksperti shqyrtues, lidhur me shqyrtimin e pretendimit te tenderuesin Ankues për çmime, e ka bërë analizën dhe kalkulimin e çmimet për njësi për të gjitha 13 ofertat pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit dhe kamë ardhë deri te çmimet e e përafërta të tregut, nga 13 ofertat financiare të pranura për këto shërbime në këtë aktivitet të prokurimit.

Për të mos u bazuar vetëm në ofertën e tenderuesit ankues, nga 13 ofertat sa kanë ofertuar është nxjerrë Çmimi mesatar për njësi dhe është bërë krahasimi i ofertës se tenderuesit të shpallur fitues, "ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan me mesataren e 13 ofertave tjerë si vijon :

Nga krahasimi i çmimeve për të tri nëntotalet e Paramasës të ndriqimit publik 2024, kemi konstatuar dallim të madh çmim shumë të ulët për njësi nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë se sa mesatarja e 13 ofertave tjera.

Analiza e çmimeve për Pjesën e Parë me peshim 80%

Në bazë të analizës, çmimi total i ofertës së "ELEKTRIKA - MONT" për Pjesën e Parë nga 42 artikuj 30 artikuj janë me cmime jonormalisht të ulëta në shumë prej 33.50 €, ndërsa mesatarja e artikujve të njëjt e këtyre 13 ofertave të tjera është 207.65 €, që tregon se totali i pjesës së parë të ofertës së rekomanduar për kontratë është për 83.55 %më i ulët se totali i çmimit mesatar të 13 ofertave tjera.

Analiza e çmimeve për Pjesën e Dytë me peshim 15%

Në bazë të analizës, çmimi total i ofertës së "ELEKTRIKA - MONT" për Pjesën e Dytë nga 26 artikuj 25 artikuj janë me cmime jonormalisht të ulëta në shumë prej 12.80 €, ndërsa mesatarja e artikujve të njëjt e këtyre 13 ofertave të tjera është 203.38 €, që tregon se totali i pjesës së dytë të ofertës së rekomanduar për kontratë është për 93.71 %më i ulët se totali i çmimit mesatar të 13 ofertave tjera.

Analiza e çmimeve për Pjesën e Tretë me peshim 5%

Në bazë të analizës, çmimi total i ofertës së "ELEKTRIKA - MONT" për Pjesën e Tretë nga 24 artikuj 23 artikuj janë me cmime jonormalisht të ulëta në shumë prej 12.50 €, ndërsa mesatarja e artikujve të njëjt e këtyre 13 ofertave të tjera është 285.43 €, që tregon se totali i pjesës së tretë të ofertës së rekomanduar për kontratë është për 95.62 %më e ulët se totali i çmimit mesatar të 13 ofertave tjera.

Nga analiza e kryer mbi çmimet e ofruara nga "Elektrika Mont" në krahasim me mesataren e ofertave të tjera, 85 % e artikujve tregojnë një çmim dukshëm më të ulët dhe mund të konsiderohen si çmime jonormalisht të ulëta.

Nga tabela e mësipërme, shihet se shumica e çmimeve edhe pas peshimit janë më shumë se 91 % më të ulëta se mesatarja, duke ngritur shqetësime mbi realizueshmërinë e ofertës. Kjo rezulton se çmimet e ofruara nga "ELEKTRIKA - MONT" janë jashtëzakonisht të ulëta dhe mund të krijojnë sfida serioze në ekzekutimin e kontratës, pastaj mundësia e problemeve gjatë implementimit, ku tenderuesi mund të mos jetë në gjendje të përmbushë kontratën sipas specifikimeve teknike.

Pretendimi i tenderuesit ankues se AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe nuk e ka zbatuar fare nenin 41 pika 6 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët është i bazuar, pasi që nuk i ka trajtuar fare çmimet jo-normalisht të ulëta të tenderuesit të rekomanduar për kontratë. Nuk ka kërkuar nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë, për të dhënë shpjegim për çmimet jo normalisht të ulëta, përmes Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, me arsyetimin të cilin ekemi pranuar nga ZPP i AK si vijon:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Lipjanit, nuk ka kërkuar sqarime për aktivitetin në fjele OE Elektriika Mont pasi që nuk kemi pasur dilema rreth çmimit, ne konsiderojmë që duke marrë parasysh që OE i rekomanduar për Kontrate ka qenë i 5ti me radhë, duke bërë krahasimin me oferta me të ulta, gjithashtu edhe me të larta ne kemi konsideruar që OE ka ofruar cmime sipas çmimit të tregut pasi që thuajse të gjithë OE kanë laramani të çmimeve në pozicione të ndryshme!

Megjithatë përgjegjësinë që bie mbi AK të marrë vendimin përfundimtar për të marrë në konsideratë sqarimet lidhur me çmimet dhe tenderin e dorëzuar, mendimin dhe vlerësimin i

ekspertit shqyrtues është se pretendim i tenderuesit ankues qëndron, sepse tenderi i tenderuesit të rekomanduar për kontratë, në shqyrtimin analitik të çmimeve të ofertuara, krahasuar me çmimin e tenderuesve tjerë -mesatarja e çmimeve për 13 oferta pjesëmarrëse të elaboruara në analizën tabelare të cekur më lartë, kamë ardhur në konstatim dhe përfundim se tenderi tij është jo-normalisht i ulët, nga 92 artikuj, 78 artikuj apo 85 % kanë çmime shumë më të ulëta se sa çmimet mesatare dhe vetëm 14 artikuj kanë çmime të njëjta-përafërta me çmimin mesatar, 27 artikuj janë me çmim të njëjtë 0.10 € andaj këto çmime është dashe të vlerësohen jonormalisht të ulëta të papranueshme për Autoritetin Kontraktues.

Nga gjithë kjo që u tha më lartë, lidhur me Nenin 61 (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët), mendoj se është pasojë e vendosjes së Kriterit për Dhënie të Kontratës nga Autoriteti Kontraktues, (Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët i poentuar), pa e analizuar në mënyrë të duhur natyrën e këtij shërbimi dhe furnizimi.

AK nuk ka arritur ta vendosë kriterin, në pajtueshmëri me Nenin 52.6. të LPP dhe Nenin 27. të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik (Kriteret e Dhënies së Kontratës), për të mundur me fituar ofertën më të volitshme me çmim më të ulët sipas peshimit. Kjo ka ardhur për arsye AK gjatë hartimit të Paramasës për ndriqimin publik, nuk ka arritur ta bëjë ndarjen duhur të kategorive të shërbimeve, në vendosje e peshës në bazë të rëndësisë së secilës "kategoritë shërbimeve".

Procedura e poentimit të çmimit nëse nuk bëhet në mënyrë të duhur si me këtë procedurë, ju jep mundësi operatorëve ekonomik që të vendosin çmime të larta në artikujt që ata mendojnë që do të porositën dhe çmime jonormalisht të ulëta në artikujt që ata mendojnë që nuk do të porositën.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i tenderuesit ankues, se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 61 të LPP, pasi nuk e ka bërë vlerësimin në pajtueshmëri me Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, janë të bazuara.

Pretendimiankimor ankuesit 2, AK ka shkelur nenin (nenin 59 të LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) Pretendimi i tenderuesit ankues se të kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2 është kërkuar: Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës sistemi 5 vjeçar apo master dega Automatika dhe Elektronika, Ndërsa Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë Elektriç Mont shpk ka paraqitur Avdurrahman Krasniqi Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës i cili është i lindur me datën 19.09.1958 i cili i bie që ky inxhinier ka 66 vjeç, dhe në bazë të ligjit të punës 03/L-212 nuk ka të drejtë punësimi me kontratën e paraqitur në mes Elektriç Mont Shpk dhe Avdurrahman Krasniqi.

Kërkesa e AK ka qenë që parakontrata të jetë me validitet e cila nënkupton që gjatë gjithë kohës se projektit ky person të jetë prezent, ndërsa ky person nuk ka të drejtë punë sipas kontratës të paraqitur (SHIKO KONTRATËN E PARAQITUR PAGESA BRUTO) sepse është mbi moshën 65 vjeçare e cila pasqyron se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës sistemi 5 vjeçar apo master dega Automatika dhe Elektronika, dhe është i papërgjegjshëm duke mos plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

Në kontratën e paraqitur mes Elektriç Mont Shpk dhe Avdurrahman Krasniqi në Nenin 4 të kontratës është e cekur paga mujore prej 600 euro BRUTO

Përgjigje në pretendimin të lartë cekur 2 (nenin 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Pretendimi i tenderuesit ankues se AK gjatë vlerësimit e ka shkelur nenin 59 të LPP-së për Kërkesën 9.1 kërkesa 2. Pika a, nuk qëndron, sepse tenderuesi i rekomanduar për kontratë është vlerësuar me të drejtë i përgjegjshëm për këtë pikë a) Inxhinieri i diplomuar i Elektroteknikës-menaxheri i projektit i prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm.

Kërkesa e AK në DT

Pretendimi i tenderuesit ankues se Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës i prezantuar (Avdurrahman Krasniqi), ka kaluar moshën 65 vjeçare dhe se nuk ka të drejtë pune sipas kontrates të paraqitur, një vlerësim i tillë nuk qëndron, sepse me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në Kosovë nuk është e përcaktuar një moshë maksimale për punësim, duke lejuar kështu që qytetarët të vazhdojnë të punojnë edhe pas moshës 65 vjeçare dhe me të drejtë tenderuesi ka nënshkruar parakontratë - Kontratë mbi vepër (për detyrë specifike) për këtë projekt si është këkuar nga AK në DT dhe normalisht punëdhënësi ka caktuar pagën Bruto, sepse edhe pas moshës 65 vjeçare i punësuar i paguan tatimin në paga, kurse nuk është i obliguar të paguaj kontribute dhe pretendimi i tenderuesit ankues se gjatë vlerësimit AK ka shkelur Nenin 59 dhe 69 të LPP-së është i pabazuar. Shenim:

Meqenëse për të njetën procedurë-aktivitet të prokurimit janë bërë 3 ankesa në OSHP me pretendime të ndryshme andaj nga shqyrtimi i ankesës tjetër tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesat kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-Kapaciteti teknik dhe profesional si është kërkuar në FTD, 9.1 & 9.2 Kërkesa 2 (b) Min Nje inxhinier i diplomuar i elektroteknikës sistemi 5 vjeçar apo master dega Automatika dhe Elektroteknika minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit.), Ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit dhe kontrollimit të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar është se, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Tenderuesi i rekomanduar për kontratë, për këtë kërkesë-pozitë të stafit profesional ka prezantuar inxhinierin (B.H) me drejtimin jo adekuat inxhinier AUTOMATIKË ME ELEKTRONIKË ejo si është këkuar Ing.dip.i Elektroteknikës apo master dega Automatika dhe elektroteknika.

Eksiston një dallim të rëndësishëm midis ekspertit të kërkuar dhe atij të ofruar si vijon: Ing. dip. Automatike dhe Elektronike fokusohet më shumë në automatizim, elektronikë dhe robotikë. Kurse Inxhinieri i Elektroteknikës fokusohet më shumë në energjinë elektrike, rrjetet elektrike dhe sistemet e shpërndarjes.

Në këtë kërkesë tenderuesi i rekomanduar për kontratë, është i papërgjegjshëm sepse inxhinieri (B.H) me kualifikim jo adekuat me atë që është kërkuar nuk mund ti realizoj detyrat e këtij projekti i cili ka për detyrë në punët e ndryshme në rrjetin elektrik, shpërndarjen e energjisë dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës elektrike. Ky profesion i ofruar nuk ka njohuritë e duhura për zgjedhjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e materialeve elektrike si kabllot, trupat ndriqes, ndriçimi publik dhe pajisjet e shpërndarjes së energjisë.

Inxhinjeri i prezantuar (B.H) nga tenderuesi është i papërgjegjshëm sepse nuk është i përfshirë fare në Listën e Stafit -ELEKTRIKA MONT SH.P.K. dhe AK-komisioni vlerësues pa të drejtë e ka kualifikuar të përgjegjshëm.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ANESI” SH.P.K., Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0070 ka vlerësuar se:

Tenderuesi Ankues, ANESI SH.P.K. Prishtinë, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 14.01.2025, përderisa AK me datë 17.01.2025 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Tenderuesi Ankues, deklaron se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN të datë 09.01.2025 dhe PRETENDON se AK, me rastin e vlerësimit të tenderëve dhe të shpalljes së fituesit për këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me Dispozitat e LPP-së dhe me dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Eksperti shqyrtues, sipas autorizimit 2025/0070, pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar në shkresat e lendes së trajtuar ka konstatuar dhe sqaron me sa vijon:

I. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES, për tenderuesin e rekomanduar për kontratë “ELEKTRIKA - MONT” SH.P.K, Lipjan

PRETENDIMI 1. I TENDERUESIT ANKUES

AK ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së pasi që gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit nuk ka luajtur aspak rol aktiv që shpenzimi i parasë publike të bëhet në mënyrë efikase, ekonomike dhe transparente si dhe nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. E themi këtë sepse AK po tenton ta shpërblej me kontratë një OE i cili nuk posedon çmimin më ulët në krahasim me neve si dhe i njëjti nuk e plotëson kriterin për njërin nga inxhinierët e kërkuar nga AK ngjashëm siç na ja bërë vërejtje edhe neve. Përpos kësaj ky OE posedon borxhe në ATK dhe se nuk ka ofruar fare dëshminë(marrëveshjen) që do të tregonte se marrëveshja për shlyerjen e borxheve është bërë para njoftimit për kontratë. Në bazë të kësaj po shihet se AK e ka favorizuar OE në fjalë dhe e ka shpërblyer me kontratë në kundërshtim me të gjitha rregullat që flasin për vlerësimin e tenderuesve duke u bazuar ekskluzivisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat ligjore që përcaktojnë përgjegjshmërinë e OE.

Vlen të thuhet se në të njëjtën kohë neve na ka eliminuar pa asnjë të drejtë ligjore edhe pse i kemi plotësuar kriteret e kërkuara për stafin dhe pajisjet, ngjashëm me OE që e ka shpallur fitues por që kemi pasur edhe çmimin më të ulët në krahasim me tenderuesin që e ka shpallur fitues. Përpos kësaj AK nuk na ka kërkuar sqarime për pajisjet tona që i kishim në listë për derisa tek tenderuesit tjerë e ka bërë këtë sqarim.

Nisur nga krejt kjo, nuk kemi se si të mos mendojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 7 të LPP-së gjatë këtij procesi të vlerësimit përkatësisht të përzgjedhjes së fituesit.

1Përgjigje në pretendimet e lartë cekura 1 (Neni 1-Qëllimi dhe 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesi ankues, se AK, ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së, është i pjesërisht i bazuar, sepse gjatë vlerësimit, AK e ka rekomanduar për kontratë

tenderuesin ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan i cili sipas vlerësimit tim është i pa përgjegjshëm dhe e ka eliminuar pa të drejtë tenderuesin ankues ANESI SH.P.K. Prishtinë i cili sipas vlerësimit tim është i përgjegjshëm, AK, nuk ju ka përmbajtur këtij Neni 1 të LPP-së, i cili ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, të siguroj integritet dhe përgjegjësi gjatë vlerësimit të tenderëve me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. AK, gjatë vlerësimit e ka rekomanduar për kontratë tenderuesin ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan i cili sipas vlerësimit tim është i pa përgjegjshëm dhe e ka eliminuar pa të drejtë tenderuesin ankues ANESI SH.P.K. Prishtinë i cili sipas vlerësimit tim është i përgjegjshëm, me këtë ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, sepse ka bërë diskriminim në trajtim, andaj në këtë rast kemi të bëjë me diskriminimin e tenderuesit ankues dhe pretendimi i tij është i pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i tenderuesit ankues 2, AK ka shkelur nenin (nenin 59 të LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Mangësia 1: AK kishte kërkuar ndër të tjera që OE të posedojnë në stafin e tyre një Inxhinier me një profesion dhe përvojë specifike. Kërkesa e tillë e AK-së duket kështu:

Me që kërkesa e AK-së për drejtimin ka qenë Automatika dhe ELEKTROTEKNIKA, del që diploma e ofruar me drejtimin Automatikë me ELEKTRONIKË të mos jetë sipas kërkesës së AK-së prandaj bazuar në nenin 59 të LPP-së del të jetë e ndryshme, çka e bënë atë të papranueshme ndërsa OE në fjalë e bënë të papërgjegjshëm. Vlen të thuhet se termi elektronikë dallon me termin elektroteknikë. Në këtë rast kjo e dyta i përgjigjet plotësisht natyrës së projektit dhe është më e afërt me diplomën që kemi dorëzuar ne se sa atë që ka dorëzuar OE i shpallur fitues.

Përpos kësaj, në listën e stafit që është kërkuar të dorëzohet si e nënshkruar dhe e vulosur, nuk figuron fare emri i personit për të cilin është dorëzuar diploma. Ja si dukej kërkesa e AK-së:

Përgjigje në pretendimin ankimor 2, të lartë cekur: 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Përgjigjja e ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit dhe kontrollimit të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar është se, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Pretendimi i tenderuesit ankues lidhur me kërkesën 9.1 & 9.2 Kërkesa 2 (b) Min Nje inxhinier i diplomuar i elektroteknikes sistemi 5 vjeqar apo master dega Automatika dhe Elektroteknika minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit.), eksperti shqyrtues konstaton se tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dëshmi, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kapaciteti teknik dhe profesional të saktësuar në DT. Pretendim i tenderuesit ankues, qëndron, sepse me kontrollimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë, shihet se për këtë kërkesë-pozitë të stafit profesional ka prezantuar inxhinierin (B.H) me drejtimin jo adekuat inxhinier AUTOMATIKË ME ELEKTRONIKË e jo si është kërkuar Ing.dip.i Elektroteknikës apo master dega Automatika dhe elektroteknika.

Pretendimi i tenderuesit të rekomanduar për kontratë, nuk e ka plotësuar kërkesën si është kërkuar në Njoftimin për kontratë dhe DT, sepse në mes të ekspertit të kërkuar dhe atij të ofruar, ekziston një dallim të rëndësishëm midis këtyre dy specializimeve, si vijon:

Ing. dip. Automatike dhe Elektronike fokusohet më shumë në automatizim, elektronikë dhe robotikë. Kurse Inxhinieri i Elektroteknikës fokusohet më shumë në energjinë elektrike, rrjetet elektrike dhe sistemet e shpërndarjes.

Në këtë kërkesë tenderuesi i rekomanduar për dhënie të kontratës, është i papërgjegjshëm sepse inxhinieri (B.H) me kualifikim jo adekuat me atë që është kërkuar nuk mund ti realizoj detyrat e këtij projekti i cili ka për detyrë në punët e ndryshme në rrjetin elektrik, shpërndarjen e energjisë dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës elektrike. Ky profesion i ofruar nuk ka njohuritë e duhura për zgjedhjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e materialeve elektrike si kabllo, trupat ndriqes, ndriçimi publik dhe pajisjet e shpërndarjes së energjisë.

Inxhinieri i prezantuar (B.H) nga tenderuesi është i papërgjegjshëm sepse nuk është i përfshirë fare në Listën e Stafit –ELEKTRIKA MONT SH.P.K. dhe pretendimi i tenderuesit ankues se gjatë vlerësimit AK ka shkelur Nenin 59 dhe 69 të LPP-së është i bazuar.

Pretendimi i tenderuesit ankues 2, AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve)

Mangësia 2: AK kishte kërkuar që OE jenë të përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së. Kjo kërkesë ishte parashtruar tek pika 6 e FDT-së.

Sipas ligjit dhe interpretimit të KRPP-së Nr. 6 të datës 22.11.2022, OE të cilët kanë borxhe në ATK por janë marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste, pranohen si të përshtatshëm me kusht që marrëveshja e tillë me ATK-në të jetë me datë më të hershme se sa data e njoftimit për kontratë. Ky OE nuk e ka dëshmuar këtë andaj nisur nga kërkesat e ligjit por edhe nga interpretimi, OE del të jetë i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm edhe në drejtim të nenin 65 të LPP-së. Ja si duket dëshmia që tregon se ky OE ka borxhe të pashlyera në ATK:

Përgjigje në pretendimin ankimor 2, Mangësia 2 e lartë cekur: neni 59 të dhe neni 65 të LPP-së (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve)

Ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit dhe kontrollimit të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar është se, Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së tenderuesit fitues ka kërkuar për pranueshmërinë e tenderuesit vërtetimit tatimor, i cili është pranuar nga ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan, të cilin vërtetim tenderuesi ankues e konteston lidhur me datën e lëshimit të vërtetimit tatimor.

Eksperti shqyrtues me qëllim të sqarimit të kësajë qështje me datë 03.02.2025 në mbështetje të nenit Neni 114 paragrafi 1 të LPP-së Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues, ka kërkuar sqarime dhe ka pranuar të njëjtën ditë marrëveshjes me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë, e cila është në pajtueshmëri me kërkesën e parashtruar në dosjen e tenderit (FTD) Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, Neni 6.4

Dëshmia: Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit, konkretisht në përputhshmëri me nenin 65

pika 5 citojmë:

Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesi ankues, se nuk është zbatuar si duhet neni 65 të LPP-së me rastin e shpalljes së tenderuesit fitues nga Autoriteti Kontraktues, është i pabazuar, sepse tenderuesi i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar vërtetimin tatimor në të cilin ka borxhe në ATK por janë në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste.

Vërtetimi i dorëzuar është me datë 30.12.2024, sipas sqarimeve të pranuar nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë "ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan është i vlefshëm, sepse marrëveshja e tillë me ATK-në është me datë më të hershme (30.04.2024) se sa data e njoftimit për kontratë ose para dorëzimit të tenderit si ka qenë kërkesa në DT.

Andaj pretendimi i tenderuesit ankues është i pa bazuar, sepse sipas ligjit dhe interpretimit të KRPP-së Nr. 6 të datës 22.11.2022, tenderuesit të cilët kanë borxhe në ATK por janë marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste, pranohen si i përshtatshëm, me kusht që marrëveshja e tillë me ATK-në të jetë me datë më të hershme se sa data e njoftimit për kontratë.

II. PRETENDIMET ANKIMORE TË TENDERUESIT ANKUES, ANESI SH.P.K. Prishtinë

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së edhe me rastin e cilësimit të tenderit tonë si të papërgjegjshëm. Arsyeimi i AK-së për eliminimin tonë duket kështu:

Tenderuesi ka dështuar të dëshmoj se në stafin e tij ka sipas Kërkesës 2.Stafi profesional, pika

b) Nje inxhinier i diplomuar i elektroteknikes sistemi 5 vjeqar apo master dega Automatika dhe Elektroteknika minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit.)

Tenderuesi ka dështuar të dëshmoj se ka në dispozicion Pajisje teknike sipas Kërkesës 3 pika

d) kamion Auto Kran = min 1 copë

II. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË TENDERUESIT ANKUES, ANESI SH.P.K. Prishtinë

Përgjigje në pretendimin ankimor, të lartë cekur: 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, lidhur me kërkesën 9.1 & 9.2 Kërkesa 3 qëndron, sepse me kontrollimin dhe rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, tenderuesi ankues ka dorëzuar dëshmi, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kapaciteti teknik dhe profesional të saktësuar në DT. Nga dokumentacioni i dorëzuar shihet se për kërkesën 2. b. tenderuesi ankues ANESI SH.P.K. Prishtinë, ka prezantuar inxhinierin e diplomuar të elektroteknikës (A.S.) me drejtimin adekuat ashtu si është kërkuar Ing.dip.i Elektroteknikës.

Përgjigjja e ekspertit shqyrtues lidhur me kërkesën 9.1 & 9.2 Kërkesa 3 pika d., (mungon dëshmia për kamion Auto Kran) pjesërisht qëndron sepse tenderuesi ankues lidhur me këtë kërkesë e ka dorëzuar Listen e pajisjeve teknike. Me këtë rast AK, gjatë vlerësimit të tenderëve varësisht nga rasti i paraqitur, duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Ku në këto raste është dhënë sqarim si të veprohet gjatë vlerësimit të tenderëve në Udhëzuesin Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, si vijon:

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste.

Kjo analogji-ngjajshmëri është e pranueshme edhe në këtë rast për pajisje teknike, meqenëse janë dorëzuar të dhëna në Listën e pajisjeve ku figuron pajisja - kamion Auto Kran, AK, ashtu si ka vepruar për tenderuesin tjetër pjesëmarrës Item EL SHPK, prej të cilit ka kërkuar sqarime gjatë vlerësimit, ti sjellin dëshmitë që i kanë munguar nga pajisjet të cilat kanë qenë të evidentuara vetëm në listë të pajisjeve teknike, kurse tenderuesin ankues e ka eliminuar për mos posedimin të dëshmisë për kamionin me kran të cilin e ka pas të evidentuar në Listen e pajisjeve teknike. Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pohimi dhe pretendimi i tenderuesit ankues se AK është dashur që në përputhje me nenin 7 të LPP-së (trajtimi i barabartë) dhe mbështetur në nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së, të kërkoj sqarimin e tenderit për këtë pajisje, andaj ky pretendim ankimor është i pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Item EL” SH.P.K., Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0072 ka vlerësuar se:

Tenderuesi Ankues, ITEM EL SH.P.K. Prishtinë, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 14.01.2025, përderisa AK me datë 17.01.2025 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Tenderuesi Ankues, deklaroi se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN të datë 09.01.2025 dhe PRETENDON se AK, me rastin e vlerësimit të tenderëve dhe të shpalljes së fituesit për këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me Dispozitat e LPP-së dhe me dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Eksperti shqyrtues, sipas autorizimit 2025/0072, pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar në shkresat e lendes së trajtuar ka konstatuar dhe sqaron me sa vijon:

I. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES, për tenderuesin e rekomanduar për kontratë “ELEKTRIKA - MONT” SH.P.K, Lipjan

PRETENDIMI 1. I TENDERUESIT ANKUES

1.AK ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së pasi që gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit nuk ka luajtur aspak rol aktiv që shpenzimi i parasë publike të bëhet në mënyrë efikase, ekonomike dhe transparente si dhe nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. E themi këtë sepse AK po tenton ta shpërblej me kontratë një OE i cili nuk posedon çmimin më ulët në krahasim me neve si dhe i njëjti nuk e plotëson kriterin për njërin nga inxhinierët e kërkuar nga AK ngjashëm siç na ja bërë vërejtje edhe neve. Përpos kësaj ky OE posedon borxhe në ATK dhe se nuk ka ofruar fare dëshminë(marrëveshjen) që do të tregonte se marrëveshja për

shlyerjen e borxheve është bërë para njoftimit për kontratë. Në bazë të kësaj po shihet se AK e ka favorizuar OE në fjalë dhe e ka shpërblyer me kontratë në kundërshtim me të gjitha rregullat që flasin për vlerësimin e tenderuesve duke u bazuar ekskluzivisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat ligjore që përcaktojnë përgjegjshmërinë e OE.

Vlen të thuhet se në të njëjtën kohë neve na ka eliminuar pa asnjë të drejtë ligjore edhe pse i kemi plotësuar kriteret e kërkuara për stafin dhe pajisjet, ngjashëm me OE që e ka shpallur fitues por që kemi pasur edhe çmimin më të ulët në krahasim me tenderuesin që e ka shpallur fitues. Përpos kësaj AK nuk na ka kërkuar sqarime për pajisjet tona që i kishim në listë për derisa tek tenderuesit tjerë e ka bërë këtë sqarim.

Nisur nga krejt kjo, nuk kemi se si të mos mendojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 7 të LPP-së gjatë këtij procesi të vlerësimit përkatësisht të përzgjedhjes së fituesit.

1Përgjigje në pretendimet e lartë cekura 1 (Neni 1-Qëllimi dhe 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesi ankues, se AK, ka shkelur nenin 1 dhe 7 të LPP-së, është i pjesërisht i bazuar, sepse gjatë vlerësimit, AK e ka rekomanduar për kontratë tenderuesin ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan i cili sipas vlerësimit tim është i pa përgjegjshëm dhe e ka eliminuar pa të drejtë tenderuesin ankues ITEM EL SH.P.K. Prishtinë i cili sipas vlerësimit tim është i përgjegjshëm, AK, nuk ju ka përmbajtur këtij Neni 1 të LPP-së, i cili ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, të siguroj integritet dhe përgjegjësi gjatë vlerësimit të tenderëve me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. AK, gjatë vlerësimit e ka rekomanduar për kontratë tenderuesin ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan i cili sipas vlerësimit tim është i pa përgjegjshëm dhe e ka eliminuar pa të drejtë tenderuesin ankues ITEM EL SH.P.K. Prishtinë i cili sipas vlerësimit tim është i përgjegjshëmka, me këtë ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, sepse ka bërë diskriminim në trajtim, andaj në këtë rast kemi të bëjë me diskriminimin e tenderuesit ankues dhe pretendimi i tij është i pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i tenderuesit ankues 2, AK ka shkelur nenin (nenin 59 të LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Mangësia 1: AK kishte kërkuar ndër të tjera që OE të posedojnë në stafin e tyre një Inxhinier me një profesion dhe përvojë specifike. Kërkesa e tillë e AK-së duket kështu:

Me që kërkesa e AK-së për drejtimin ka qenë Automatika dhe ELEKTROTEKNIKA, del që diploma e ofruar me drejtimin Automatikë me ELEKTRONIKË të mos jetë sipas kërkesës së AK-së prandaj bazuar në nenin 59 të LPP-së del të jetë e ndryshme, çka e bënë atë të papranueshme ndërsa OE në fjalë e bënë të papërgjegjshëm. Vlen të thuhet se termi elektronikë dallon me termin elektroteknikë. Në këtë rast kjo e dyta i përgjigjet plotësisht natyrës së projektit dhe është më e afërt me diplomën që kemi dorëzuar ne se sa atë që ka dorëzuar OE i shpallur fitues.

Përpos kësaj, në listën e stafit që është kërkuar të dorëzohet si e nënshkruar dhe e vulosur, nuk figuron fare emri i personit për të cilin është dorëzuar diploma. Ja si dukej kërkesa e AK-së:

Përgjigje në pretendimin ankimor 2, të lartë cekur: 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Përgjigja e ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit dhe kontrollimit të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar është se, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, në pajtim me nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Pretendimi i tenderuesit ankues lidhur me kërkesën 9.1 & 9.2 Kërkesa 2 (b) Min Nje inxhinier i diplomuar i elektroteknikes sistemi 5 vjeqar apo master dega Automatika dhe Elektroteknika minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit.), eksperti shqyrtues konstaton se tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dëshmi, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-Kapaciteti teknik dhe profesional të saktësuar në DT. Pretendim i tenderuesit ankues, qëndron, sepse me kontrollimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë, shihet se për këtë kërkesë-pozitë të stafit profesional ka prezantuar inxhinierin (B.H) me drejtimin jo adekuat inxhinier AUTOMATIKË ME ELEKTRONIKË e jo si është kërkuar Ing.dip.i Elektroteknikës apo master dega Automatika dhe elektroteknika.

Pretendimi i tenderuesit të rekomanduar për kontratë, nuk e ka plotësuar kërkesën si është kërkuar në Njoftimin për kontratë dhe DT, sepse në mes të ekspertit të kërkuar dhe atij të ofruar, ekziston një dallim të rëndësishëm midis këtyre dy specializimeve, si vijon:

Ing. dip. Automatike dhe Elektronike fokusohet më shumë në automatizim, elektronikë dhe robotikë. Kurse Inxhinieri i Elektroteknikës fokusohet më shumë në energjinë elektrike, rrjetet elektrike dhe sistemet e shpërndarjes.

Në këtë kërkesë tenderuesi i rekomanduar për dhënie të kontratës, është i papërgjegjshëm sepse inxhinieri (B.H) me kualifikim jo adekuat me atë që është kërkuar nuk mund ti realizoj detyrat e këtij projekti i cili ka për detyrë në punët e ndryshme në rrjetin elektrik, shpërndarjen e energjisë dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës elektrike. Ky profesion i ofruar nuk ka njohuritë e duhura për zgjedhjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e materialeve elektrike si kabllot, trupat ndriqes, ndriçimi publik dhe pajisjet e shpërndarjes së energjisë.

Inxhinjeri i prezantuar (B.H) nga tenderuesi është i papërgjegjshëm sepse nuk është i përfshirë fare në Listën e Stafit –ELEKTRIKA MONT SH.P.K. dhe pretendimi i tenderuesit ankues se gjatë vlerësimit AK ka shkelur Nenin 59 dhe 69 të LPP-së është i bazuar.

Pretendimi i tenderuesit ankues 2, AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve)

Mangësia 2: AK kishte kërkuar që OE jenë të përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së. Kjo kërkesë ishte parashtruar tek pika 6 e FDT-së.

Sipas ligjit dhe interpretimit të KRPP-së Nr. 6 të datës 22.11.2022, OE të cilët kanë borxhe në ATK por janë marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste, pranohen si të përshtatshëm me kusht që marrëveshja e tillë me ATK-në të jetë me datë më të hershme se sa data e njoftimit për kontratë. Ky OE nuk e ka dëshmuar këtë andaj nisur nga kërkesat e ligjit por

edhe nga interpretimi, OE del të jetë i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm edhe në drejtim të nenin 65 të LPP-së. Ja si duket dëshmia që tregon se ky OE ka borxhe të pashlyera në ATK:

Përgjigje në pretendimin ankimor 2, Mangësia 2 e lartë cekur: neni 59 të dhe neni 65 të LPP-së (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve)

Ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit dhe kontrollimit të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar është se, Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së tenderuesit fitues ka kërkuar për pranueshmërinë e tenderuesit vërtetimit tatimor, i cili është pranuar nga ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan, të cilin vërtetim tenderuesi ankues e konteston lidhur me datën e lëshimit të vërtetimit tatimor.

Eksperti shqyrtues me qëllim të sqarimit të kësajë qështje me datë 03.02.2025 në mbështetje të nenit Neni 114 paragrafi 1 të LPP-së Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues, ka kërkuar sqarime dhe ka pranuar të njëjtën ditë marrvëshjes me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë, e cila është në pajtueshmëri me kërkesën e parashtruar në dosjen e tenderit (FTD) Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, Neni 6.4

1 Dëshmia: Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit, konkretisht në përputhshmëri me nenin 65 pika 5 citojmë:

5.Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesi ankues, se nuk është zbatuar si duhet neni 65 të LPP-së me rastin e shpalljes së tenderuesit fitues nga Autoriteti Kontraktues, është i pabazuar, sepse tenderuesi i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar vërtetimin tatimor në të cilin ka borxhe në ATK por janë në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste.

Vërtetimi i dorëzuar është me datë 30.12.2024, sipas sqarimeve të pranuar nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë "ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan është i vlefshëm, sepse marrëveshja e tillë me ATK-në është me datë më të hershme (30.04.2024) se sa data e njoftimit për kontratë ose para dorëzimit të tenderit si ka qenë kërkesa në DT.

Andaj pretendimi i tenderuesit ankues është i pa bazuar, sepse sipas ligjit dhe interpretimit të KRPP-së Nr. 6 të datës 22.11.2022, tenderuesit të cilët kanë borxhe në ATK por janë marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve me këste, pranohen si i përshtatshëm, me kusht që marrëveshja e tillë me ATK-në të jetë me datë më të hershme se sa data e njoftimit për kontratë.

Pretendimi i tenderuesit ankues 3, AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët)

Mangësia 3: Kjo mangësi lidhet me çmimet jo-normalisht të ulëta të ofruara nga OE i shpallur fitues ku disa prej tyre shihen hapur se janë shumë më të ulëta se sa çmimet e tregut. Këto çmime jo-normalisht të ulëta ky OE i posedon në disa nga pozicionet e listës së çmimeve për të cilat është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm sepse nuk ekziston asnjë mundësi teorike e as praktike që të mund të liferohen me çmimin e tillë. Në vazhdim po i paraqesim vetëm disa nga

çmimet e tilla që ndodhen tek tabela e dytë dhe e tretë e listës së çmimeve:

3. AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët pasi që nuk i ka trajtuar fare çmimet jo-normalisht të ulëta të OE që e ka shpallur fitues. Ky OE ka ofertuar me çmime spekulative pasi që në disa pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta (0.10€) ndërsa në disa pozicione ka ofruar edhe çmime shumë të larta.

Në vazhdim po e paraqesim si të pjesshme listën e çmimeve të OE të shpallur fitues nga ku mundeni të shihni edhe vet se si janë ofruar çmime spekulative në këtë rast:

1.Përgjigje në pretendimin e lartë cekur -Nenin 61(Tenderët Jo-Normalisht të Ulët),)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesi ankues, se nuk është zbatuar si duhet 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores nr.001/2022 për PP me rastin e vlerësimit të tenderëve (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) nga Autoriteti Kontraktues, është plotësisht i bazuar, sepse në ofertën e Tenderuesit të shpallur fitues, "ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan kam konstatuar se kemi të bëjmë me tender jo normalisht të ulët në krahasim me objektin e kontratës dhe krahasimin e çmimeve me ofertuesit tjerë dhe me çmimet e tregut për këtë shërbim dhe furnizime, pasi që i në ofertën totale përmbush vetëm 2 kushtet si vijon:

Neni 3 Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii.janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Eksperti shqyrtues, pas analizës dhe llogaritjes së ofertave financiare të tenderuesve pjesëmarrës, ka konstatuar se AK gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 61 të LPP-se, të ofertës së Tenderuesit të rekomanduar për kontratë, "ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan si ofertë TOTALE i përmbush dy kushtet dhe si rrjedhojë konsiderohet tender jo normalisht i ultë, kurse sa i përket çmimeve për njësi-artikull i përmbush në tërësi të gjitha kushtet ligjore nga neni nenin 41 pika 6 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik dhe si rrjedhojë mund të konsiderohet dhe të trajtohet oferta jo normalisht të ulëta dhe mund të refuzohen si tender jo-normalisht i ulët.

Eksperti shqyrtues, lidhur me shqyrtimin e pretendimit të tenderuesin Ankues për çmime, e ka bërë analizën dhe kalkulimin e çmimet për njësi për të gjitha 13 ofertat pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit dhe kamë ardhë deri të çmimet e e përafërta të tregut, nga 13 ofertat financiare të pranura për këto shërbime në këtë aktivitet të prokurimit.

Për të mos u bazuar vetëm në ofertën e tenderuesit ankues, nga 13 ofertat sa kanë ofertuar është nxjerrë Çmimi mesatar për njësi dhe është bërë krahasimi i ofertës së tenderuesit të shpallur fitues, "ELEKTRIKA - MONT" SH.P.K, Lipjan me mesataren e 13 ofertave tjerë si vijon:

Nga krahasimi i çmimeve për të tri nëntoret e Paramasës të ndriqimit publik 2024, kemi konstatuar dallim të madh çmim shumë të ulët për njësi nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë se sa mesatarja e 13 ofertave tjera.

Analiza e çmimeve për Pjesën e Parë me peshim 80%

Në bazë të analizës, çmimi total i ofertës së "ELEKTRIKA - MONT" për Pjesën e Parë nga 42 artikuj 30 artikuj janë me cmime jonormalisht të ulëta në shumë prej 33.50 €, ndërsa mesatarja e artikujve të njejt e këtyre 13 ofertave të tjera është 207.65 €, që tregon se totali i pjesës së parë të ofertës së rekomanduar për kontratë është për 83.55 % më i ulët se totali i çmimit mesatar të 13 ofertave tjera.

Analiza e çmimeve për Pjesën e Dytë me peshim 15%

Në bazë të analizës, çmimi total i ofertës së "ELEKTRIKA - MONT" për Pjesën e Dytë nga 26 artikuj 25 artikuj janë me cmime jonormalisht të ulëta në shumë prej 12.80 €, ndërsa mesatarja e artikujve të njejt e këtyre 13 ofertave të tjera është 203.38 €, që tregon se totali i pjesës së dytë të ofertës së rekomanduar për kontratë është për 93.71 % më i ulët se totali i çmimit mesatar të 13 ofertave tjera.

Analiza e çmimeve për Pjesën e Tretë me peshim 5%

Në bazë të analizës, çmimi total i ofertës së "ELEKTRIKA - MONT" për Pjesën e Tretë nga 24 artikuj 23 artikuj janë me cmime jonormalisht të ulëta në shumë prej 12.50 €, ndërsa mesatarja e artikujve të njejt e këtyre 13 ofertave të tjera është 285.43 €, që tregon se totali i pjesës së tretë të ofertës së rekomanduar për kontratë është për 95.62 % më e ulët se totali i çmimit mesatar të 13 ofertave tjera.

Nga analiza e kryer mbi çmimet e ofruara nga "Elektrika Mont" në krahasim me mesataren e ofertave të tjera, 85 % e artikujve tregojnë një çmim dukshëm më të ulët dhe mund të konsiderohen si çmime jonormalisht të ulëta.

Nga tabela e mësipërme, shihet se shumica e çmimeve edhe pas peshimit janë më shumë se 91 % më të ulëta se mesatarja, duke ngritur shqetësime mbi realizueshmërinë e ofertës. Kjo rezulton se çmimet e ofruara nga "ELEKTRIKA - MONT" janë jashtëzakonisht të ulëta dhe mund të krijojnë sfida serioze në ekzekutimin e kontratës, pastaj mundësia e problemeve gjatë implementimit, ku tenderuesi mund të mos jetë në gjendje të përmbushë kontratën sipas specifikimeve teknike.

Pretendimi i tenderuesit ankues se AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe nuk e ka zbatuar fare nenin 41 pika 6 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët është i bazuar, pasi që nuk i ka trajtuar fare çmimet jo-normalisht të ulëta të tenderuesit të rekomanduar për kontratë. Nuk ka kërkuar nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë, për të dhënë shpjegim për çmimet jo normalisht të ulëta, përmes Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, me arsyetimin të cilin ekemi pranuar nga ZPP i AK si vijon:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Lipjanit, nuk ka kerkuar sqarime per aktivitetin ne fjele OE Elektriika Mont pasi qe nuk kemi pasur dilema rreth cmimit, ne konsiderojme qe duke mare parasyshe qe OE i rekomanduar per Kontrate ka qene i 5ti me radhe, duke bere krahasimini me oferta me te ulta, gjithashtu edhe me te larta ne kemi konsideruar qe OE ka ofruar cmime sipas cmimit te tregut pasi qe thuajse te gjithe OE kane laramani te cmimeve ne pozicione te ndryshme!

Megjithë përgjegjësinë që bie mbi AK të merr vendimin përfundimtar për ti marrë në konsideratë sqarimet lidhur me çmimet dhe tenderin e dorëzuar, mendimimi dhe vlerësimi i ekspertit shqyrtues është se pretendim i tenderuesit ankues qëndron, sepse tenderi i tenderuesit të rekomanduar për kontratë, në shqyrtimin analitik të çmimeve të ofertuara, krahasuar me çmimin e tenderuesve tjerë –mesatarja e çmimeve për 13 oferta pjesëmarrëse të elaboruara në analizën tabelare të cekur më lartë, kamë ardhur në konstatim dhe përfundim se tenderi tij është jo-normalisht i ulët, nga 92 artikuj, 78 artikuj apo 85 % kanë çmime shumë më të ulëta se sa çmimet mesatare dhe vetëm 14 artikuj kanë çmime të njëjta-përafërta me çmimin mesatar, 27 artikuj janë me çmim të njetë 0.10 € andaj këto çmime është dashe të vlerësohen jonormalisht të ulëta të papranueshme për Autoritetin Kontraktues.

Nga gjithë kjo që u tha më lartë, lidhur me Nenin 61(Tenderët Jo-Normalisht të Ulët), mendoj se është pasojë e vendosjes së Kriterit për Dhënie të Kontratës nga Autoriteti Kontraktues, (Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët i poentuar), pa e analizuar në mënyrë të duhur natyrën e këtij shërbimi dhe furnizimi.

AK nuk ja ka arritur ta vendos kriterin, në pajtueshmëri me Nenin 52.6. të LPP dhe Nenin 27. të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik (Kriteret e Dhënies së Kontratës), për të mundur me fituar ofertën më të volitshme me çmim më të ulët sipas peshimit. Kjo ka ardhur për arsye AK gjatë hartimit të Paramasës për ndriqimin publik, nuk ka arritur ta bëjë ndarjen duhur të kategorive të shërbimeve, në vendosje e peshës në bazë të rëndësisë se secilës “kategori të shërbimeve”.

Procedura e poentimit të çmimit nëse nuk bëhet në mënyrë të duhur si me këtë procedurë, ju jep mundësi operatorëve ekonomik që të vendosin çmime të larta në artikujt që ata mendojnë që do të porositën dhe çmime jonormalisht të ulëta në artikujt që ata mendojnë që nuk do të porositën.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i tenderuesit ankues, se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 61 i LPP, pasi nuk e ka bërë vlerësimin në pajtueshmëri me Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët, janë të bazuara.

II. PRETENDIMET ANKIMORE TË TENDERUESIT ANKUES, ITEM EL SH.P.K. Prishtinë

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së edhe me rastin e cilësimit të tenderit tonë si të papërgjegjshëm. Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë duket kështu:

II. PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË TENDERUESIT ANKUES, ITEM EL SH.P.K. Prishtinë

Përgjigje në pretendimin ankimor, të lartë cekur: 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, lidhur me kërkesën 9.1 & 9.2 Kërkesa 3 qëndron, sepse me kontrollimin dhe rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, tenderuesi ankues ka dorëzuar dëshmi, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kapaciteti teknik dhe profesional të saktësuar në DT. Nga dokumentacioni i dorëzuar shihet se për kërkesën 2. b. tenderuesi ankues ITEM EL SH.P.K. Prishtinë, ka prezantuar inxhinierin e diplomuar të elektroteknikës (A.S.) me drejtimin adekuat

ashtu si është kërkuar Ing.dip.i Elektroteknikës.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik sipas nr 2025/0069 dhe 2025/0070 aprovohet si pjesërishte e bazuar ndersa ankesa me nr 2025/0073 si bazuar për faktin se Paneli Shqyrtues ka analizuar oferten financiare të OE-së i cili është rekomanduar për dhanje të kontratës në çmimet e ofruar tek Lista e çmimeve konsiderohen si çmime spekulative artikujt tek pjesa I e paramases artikujt me nr rendor 28,38, Pjesa II e paramases artikulli nr 5,6,7,8,9,10,16,17,18,19,20 ,21,22,23, , pjesa III e paramases artikujt 4,5,6,7,8,13,19,20,21,22,23 jane ofruar çmimet prej 0.10 cent, pa i përfshier artikujt tjerë ndërsa gjatë vlersimit të ofertave AK-ja nuk ka vepruar ne përputhje me nenin 41 paragrafi 41.2 të RrPP-se, ngase sipas te gjeturave ne sistem për këtë aktivitet të prokurimit AK-ja ka perdorur formularin B41 per tenderët jo normalishtë të ulët vetëm për GOE TALA ENGINEERING SH.P.K & CONSTRUCITON GROUP SH.P.K & MUHAREM HOTI B.I-Prishtinë , lidhur me çmimet e ofruar si jo-normalisht të ulët , ndërsa oferten e OE-së të rekomanduar e ka trajtuar si të mirqenur pa aplikuar nenin 41 te RrPP-së e që është në kundërshtim me nenin 1, dhe 7 të LPP-së ngase të gjithë ofertuesit duhet të trajtohen të barabartë , poashtu sipas pretendimit ankimor lidhur me inxhinjerin sipas kerkeses b) , sipas NJK dhe DT (B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara) tek kerkesat mbi mundësit teknike/profesionale është kërkuar b) Min Nje inxhinier i diplomuar i elektroteknikes sistemi 5 vjeqar apo master dega Automatika dhe Elektroteknika minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit, sipas ofertes të OE i rekomanduar per kontrate është ofruar inxhinjeri B.H ,ku drejtimi i kerkuar nga AK-ja ndryshon, nuk është sipas NK dhe DT-se ngase inxhinjeri B.H . sipas diplomës figuron të jetë drejtimi ndryshe nga ajo e kerkuar: Automatikë me elektronikë. Ndërsa lidhur me eliminimin e OE “ANESI” SH.P.K., me nr. 2025/0070 sipas pretendimit ankimor lidhur me paisjen auto-kran , ne ofertë konstatohet se nuk ka dorezuar deshmit siq jane kerkuar ne NJK, dhe DT B54 (Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara).Tek Kapaciteti Teknik/Profesional: Kerkesa nr 3 ku është kërkuar d) kamion Auto Kran = min 1 copë, *Dëshmia e kërkuar dokumentare*:3. Lista e paisjeve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, per automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, te

gjitha ato mjete qe paraqiten me fatur të blerjes duhet te kene te bashkangjitur edhe dudin doganor. Për automjetet qe regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në këto raste Paneli Shqyrtues konsideron se OE gjate ofertimit duhet të jenë të kujdeshëm gjatë aplikimit ku konsiderohet qe kan pervojë te mjaftueshme se si të ofertojnë, dhe kjo nuk është për fajin e AK-së. Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore lidhur me vertetimet tatimore ne NJK dhe DT eshte kerkuar 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit, sipas të gjeturave në raportin e ekspertit shqyrtues marrvëshja ne mes ATK- dhe OE i cili është rekomanduar për kontratë është e datës 30.04.2024 , ndërsa publikimi i kësaj procedure është e dates 17.07.2024. (Marrvëshja e lidhur sipas muajve/ ditëve kalendarike i bije të jetë 2 muaj e 17 ditë).

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur ta mbështes raportin e ekspertit shqyrtues lidhur me rekomandimin për të anuluar B58Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim, dhe gjatë rivlerësimit AK të veprojnë në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në Ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - TALA ENGINEERING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: